

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë,
Master i Shkencave në “Infermieri”

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Prof. Dr. Aleksandër Dhima – Kryetar
2. MSc. Anisa Hoxha – Anëtare
3. MSc. Kujtim Mulgeci – Anëtar
4. Xhoana Shabani – Studente

Maj 2021

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES VLERËSIMI TË BRENDSHËM

Programi i studimit Master i Shkencave, shkurtimisht MSH në “Infermieri”, është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (UMASR) Nr. 665, datë 12.10.2018¹, si program i studimeve universitare të ciklit të dytë.

Në përputhje me Pikën 2 të UMASR Nr. 665, datë 12.10.2018, programi i studimit filloi veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019 dhe është në proces akreditimi për herë të parë. Programi ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 530, datë 04.09.2018², “Për hapjen e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike”, në Universitetin Europian të Tiranës”.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Infermieri”.

Ky program bazohet në misionin dhe strategjinë e UET për një formim shkencor bashkëkohor, duke u bazuar në tekste bazë mësimore nga autorë të njohur ndërkombëtarisht në vendet e Europës dhe në SHBA, si dhe në programe të hartuara me kompetencë nga pedagogët duke u mbështetur në modelet më të mira të universiteteve prestigjioze. Programi MSH Infermieri ndërthur lëndë me karakter teorik dhe praktik për të realizuar arsimimin cilësor të studentëve.

Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit formulohen si më poshtë:

- ✓ Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Infermieri” ka për qëllim të përgatisë dhe të formojë një figurë më të specializuar të infermierit pa u specifikuar në profile, në mënyrë që në përfundim të ciklit dy vjeçar, profesionisti të ketë njohuri të detajuara multidisiplinare, jo vetëm në nivel teorik, por edhe praktik.
- ✓ Programi synon të thellojë me tej këto njohuri që përmendem në disa specialitete të shkencave infermieristike, si në infermieristikën kirurgjikale, atë të sëmundjeve të brendshme, infermieristika materno-infantile apo diagnoza imazherike, duke e shtrirë më tej formimin e infermierit. I gjithë ky cikël i nivelit të dytë synon të bëjë të aftë infermierët që të sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve dhe ecurinë e asistencës në specialitete të ndryshme të mjekësisë duke i bërë ata të gatshëm për t’u punësuar në pavjone të ndryshme spitalore.

Për të arritur këto objektiva programi është konceptuar dhe organizuar me gërshetimin e njohurive teorike thelbësore me praktiken klinike. Studentet aftësohen duke shërbyer si infermierë apo asistentë në pavjone të ndryshme të specialiteteve shëndetësore.

¹ UMASR Nr. 665, dt. 12.10.2018 “Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” në “Infermieri”, në Universitetin Europian të Tiranës” (Ref. Nr. 54)

² UMASR Nr. 530, dt. 04.09.2018 “Për hapjen e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike”, në Universitetin Europian të Tiranës”. (Ref. Nr. 54.2)

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Universiteti European i Tiranës, në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka aplikuar me Shkresë Nr. 06/24, datë 30.04.2020, për akreditimin e programit të studimit.

Aplikimi është kryer pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në përputhje me parashikimet e Manualit: *“Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”*, i ndryshuar. Me kryerjen e aplikimit, UET mori masa me strukturat përkatëse për fillimin e procesit të vlerësimit të brendshëm. Rezultati i procesit të vlerësimit të brendshëm është ky Raport dhe dokumentacioni mbështetës, pjesë e Dokumentacionit të Vetë-Vlerësimit të programit (DVV).

Raporti është përgatitur nga një grup pune i ngritur me Urdhër të Rektorit, Nr. 15, datë 21.12.2020, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e UET. Në përzgjedhjen e anëtarëve të grupit, është mbajtur parasysh kompetenca profesionale, përvoja mësimdhënëse, aftësitë analizuese, mundësitë për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanëshm, shkalla e nevojshme të njohjes së institucionit, si dhe profile individual profesional. Në punën për hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Në konsultim me personelin akademik, stafin administrativ dhe studentët e Universitetit European të Tiranës, anëtarët e Grupit të punës në analizën e tyre kanë vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, në ecurinë e personelit akademik përgjegjës për realizimin e tij, në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion, si edhe në parametra të tjerë me rëndësi për procesin e akreditimit të programit të studimit MSH në “Infermieri”.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it. Grupit i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të gjitha të dhënat statistikore që nevojiten për procesin e akreditimit periodik, të cilat janë përfshirë në Raport dhe që janë të strukturuar edhe në formën e tabelave dhe grafikëve.

Në mbështetje të këtij Raporti, bashkangjitur është edhe lista e dokumenteve bazë që kanë qënë të nevojshme për hartimin e tij në lidhje me procesin e akreditimit të parë të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Infermieri”.

Ecuria e procesit është ndjekur nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, të cilët kanë asistuar GVB dhe kanë koordinuar procesin e mbledhjes së të dhënave. GVB ka zhvilluar takime të herëpashershme me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, takime të fokusuar në orientimet e nevojshme në lidhje me procesin e hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm, udhëzuesit dhe template-t për shkrimin e raportit. Gjatë takimit të parë u propozua dhe u miratua dhe plani i punës, me hapat dhe afatet deri në dorëzimin e draftit përfundimtar të raportit. Ndërsa, gjatë punës për hartimin e Raportit, janë reflektuar konstatime dhe plotësime nga aktorët e konsultuar në këtë proces.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Infermieri”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i Arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave” /“Master i Arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit është në harmoni me interesat kombëtare dhe synon nxitjen dhe respektimin e tyre, në përputhje me modelin e përzgjedhur si vizion të UET, sipas së cilit arsimit të lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi, modeli sipas së cilit universitetet po bëhen burimi i shpërndarjes së profesionalizmit dhe etikës qytetare, modeli sipas së cilit universitetet janë në linjën e parë të respektimit të kodeve të sjelljes së mirë në të gjitha fushat ³ .
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit mbështeten në misionin e UET, i cili ka synim t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare ⁴ . Universiteti harton vazhdimisht aktivitete akademike (psh. konferenca, forume, takime me të ftuar, bashkëpunime me Urdhrin e Infermierit) dhe social-kulturore (psh. klubi i Hipokratit, promovim librash, etj.) konform këtij kriteri.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programet e studimit të ofruara nga Universiteti Europian i Tiranës janë në përputhje të plotë me misionin, qëllimet dhe fushën e veprimtarisë të një institucioni të arsimit të lartë ⁵ . “UET” promovon vlerat dhe praktikatat më të mira të arsimit të lartë. Programi i studimit MSH në Infermieri përgatit infermierë të specializuar, duke iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe perspektivës së tregut të punës në Shqipëri dhe më gjerë.
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i Arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Fakulteti mban në konsideratë zhvillimin ekonomik dhe strategjik të vendit gjatë hartimit të programeve të studimit, me qëllim që të nxisë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, lokal dhe kombëtar. Kjo vjen edhe në përputhje me vizionin ⁶ e UET për të qënë një qendër ekselence me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal. Nevojat për infermierë janë shtuar në vendin tonë si pasojë e kërkesave jo vetëm spitalore (aq më tepër kur e aplikojmë edhe në kohën e pandemisë Covid-19), por edhe të qendrave shëndetësore publike dhe private në rritje, si edhe emigrimit të konsiderueshëm të infermierëve në vendet e BE, kështu që ky program synon të plotësojë nevojat për infermierë në tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik kombëtar.

³ Plani strategjik 2015-2020; 2021-2025, Vizioni, pika 9, fq. 3 (Ref. Nr. 3; 3.3);

⁴ Statuti i UET, Neni 6, pika 6.2 (Ref. Nr. 2)

⁵ Statuti i UET, Neni 6, (Ref. Nr. 2)

⁶ Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020; 2021-2025, Vizioni, pika 1.1 (Ref. Nr. 3.1; 3.2)

<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave” / “Master i Arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Si program i Ciklit të Dytë të studimeve, kurrikula e MSH në “Infermieri” ofron njohuri shkencore dhe profesionale të plota që mundësojnë ndjekjen më tej të studimeve të ciklit të tretë të Doktoratës për ata infermierë që kanë interes për të ndjekur ciklin e tretë të studimeve nëse është në planet e tyre afatgjata profesionale. Në rregulloren e programit të studimit⁷, shprehen synimet e tij, ndër të tjera, në thellimin e njohurive të studentëve të aftësohen me kompetencat e duhura për të ushtruar profesionin si dhe për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor, të nevojshme në studimet e ciklit të tretë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Programi i studimit MSH është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programet e studimit të hartuara dhe të ofruara nga Universiteti European i Tiranës janë në përputhje të plotë me strategjinë dhe qëllimet e një institucioni të arsimit të lartë me frymë europiane, që kërkon t’i përgjigjet nevojave të tregut të punës, zhvillimit ekonomik të vendit dhe ruajtjes së vlerave kulturore të kombit. Programi i studimit MSH në Infermieri është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET. Ai është konform objektivave strategjike për zhvillimin⁸.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Drejtimet prioritare akademike janë të përcaktuara në dokumentet themelore të institucionit. Në këto dokumente shprehet fakti se UET synon ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, TI, komunikimit, etj., por mbetet i hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës dhe UET ka mundësitë njerëzore e financiare për t’i aplikuar ato. Gjithsesi në dekadën e tij të dytë, Institucioni ka vendosur zgjerimin e fushave të studimit në të cilat ofron programe studimi, duke akomoduar më mirë kërkesat që vijnë nga studentët por edhe tregu i punës. Bazuar në Nenet 1, 5, 6 dhe Nenit 10, pika 10.1 të Statutit të UET-it, si edhe Nenit 1 të rregullores së UET-it, dhe Strategjisë së Kërkimit Shkencor të UET 2017-2020 dhe 2021-2025, ku përcaktohen qartë drejtimet prioritare</p>

⁷ Rregullore e programit të studimit, MSH Infermieri, pika 3.3 (Ref. Nr. 7)

⁸ Statuti i UET, Neni 6, pika 6.3 (Ref. Nr. 2)

	<p>akademike të këtij institucioni, kriteri rezulton i plotësuar. Këto nene demostrojnë se programi i studimit të Master i Shkencave në “Infermieri” është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre drejtimeve akademike.⁹</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.</p>	<p>Kërkesa sipas këtij kriteri është e theksuar edhe në Nenet 1, 5, 6 dhe Neni 10 pika 10.1, dhe 36 të Statutit të UET-it, Neni 1 të Rregullores së UET-it, dhe Strategjisë së Kërkimit Shkencor së UET (2017-2020; 2021-2025): emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohet në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.¹⁰</p> <p>Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky master është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, ku lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmblyëse.¹¹</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” / “Master i Arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi është ndërtuar në përputhje me prioritetet e UET duke shfrytëzuar eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore, kërkesave të “Kartës së Bolonjës”, përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut, mundësinë e përvetësimit sa më të mirë të tyre. Realizimi i këtij kriteri dëshmohet edhe nga rezultatet e studimeve të tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit “Infermieri” është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesat kombëtare dhe trendet globale të zhvillimit. Nder objektivat dhe strategjitë kryesore që ka UET janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Edukimi i studentëve për një jetë qytetare aktive me impakt në zhvillimin e shoqërisë dhe promovimin e standardeve të demokracisë në Shqipëri. • Zhvillimi dhe konsolidimi i një baze të gjerë e të përshtatshme dijetarësh në shërbim të vendit. • Formimi i një force pune të kualifikuar për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi dhe atij rajonal në veçanti. • Përmbyllja e aspiratave të brezit të ri për zhvillim. <p>(Referuar dokumentit Strategjia e mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve Universiteti Europian i Tiranës 2015-2020)¹²</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

⁹ Statuti i UET (Ref. Nr. 2); Rregullore e UET (Ref. Nr. 5); Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020; 2021-2025 (Ref. Mr. 3.1; 3.2)

¹⁰ Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020; 2021-2025, Vizioni, pika 1.1 (Ref. Nr. 3.1; 3.2)

¹¹ Kurrikula e prgramit MSH Infermieri (Ref. Nr. 14)

¹² Plani Strategjik 2015-2020; 2021-2025 (Ref. Nr. 3; 3.3)

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit MSH “Infermieri” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, duke përfshirë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale me të cilat pajiset studenti në përfundim të tij. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit, si edhe mundësitë e punësimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit MSH Infermieri. Ndarja në profile në këto program nuk aplikohet, megjithatë programi i studimit është hartuar duke pasur në konsideratë zhvillimin ekonomik dhe perspektivën e tregut të punës në Shqipëri, duke e lehtësuar vendosjen e profesionistit të ardhshëm në punën e pershtatshme. Infermierët me MSH janë ndër profesionistët më të kërkuar jo vetëm në sektorin publik, por edhe atë privat.¹³</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimore, UET-i konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuar në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel Fakulteti, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Dekani i fakultetit është përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me Bordet e Tregut të Punës dhe për tërheqjen e kontributeve të tyre.¹⁴</p> <p>Raste të bashkëpunimeve të tilla mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none">- Takimin e fundit me Bordin e tregut të punës të përfaqësuar nga Drejtorë Spitalesh, Drejtues të Shoqatës së Infermierisë, Drejtues të lartë të Ministrisë së Shëndetësisë në Shqipëri dhe mjekë e infermierë.- Dita e hapur e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike organizuar në 2019 dhe 2020 ku ishin të ftuar përfaqësues të ndryshëm të organizatave dhe bizneseve në fushën e Shkencave Mjekësore Teknike ku u mundësua kontakti i studentëve me këto organizata dhe kompani lidhur me përditësimin e studentëve për zhvillimet në këtë ne to, nevojat e institucioneve/kompanive dhe mundësitë e punësimit të studentëve.¹⁵ <p>Duke qenë se është viti i parë i diplomimit të studentëve të Masterit Shkencor, UET nuk ka shume të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar, por UET mbledh dhe synon të mbajë rekorde të tilla. Gjithashtu UET ka database si formularin <i>B.I.6</i></p>

¹³ Rregullore e programit të studimit (Ref. Nr. 7); Plani Strategjik për zhvillimin e programit (Ref. Nr. 4)

¹⁴ Bordi i Tregut të Punës & Network i bashkëpunëtorëve FSHMT (Ref. Nr. 12.1)

¹⁵ Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019 (Ref. Nr. 12.2); Realitetet e reja të post-Covid 19 në tregun e punës 2020 (Ref. Nr. 12.3); Te dhëna mbi aktivitetet FSHMT (Ref. Nr. 43.2)

	/ <i>Tabela përmbledhese e praktikës profesionale</i> ku ruajmë të dhënat për Institucionet si spitale, qendra shëndetësore etj, si edhe personat e kontaktit ku studentët e Infermierisë kanë kryer praktikat profesionale ¹⁶ .
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Duke qene se objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet dhe pritshmëritë e të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Në mënyrë më specifike Masteri Shkencor në Infermieri, ofron njohuritë e duhura teorike dhe i aftëson praktikisht studentët në fushën e Infermieristikës sipas lendeve përkatëse.¹⁷</p> <p>Niveli i dijeve të ofruara në programet e lëndëve është i përshtatshëm për nivelin e ciklit të dytë të studimeve. Marrja e njohurive praktike i përgjigjet më së miri tregut të punës dhe ua bën më të lehtë studentëve për tu përshtatur me mjedisin e punës. Praktikrat janë zhvilluar në qendra shëndetësore për tu njohur nga afër me detyrat që do të ketë Infermieri i cili do të punosohet në pozicione pune të ngjashme.¹⁸</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>UET si Institucion i Arsimit të Lartë ka aktive programe të studimit të cilat janë të akredituara apo në proces akreditimi, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Hartimi i programit të studimit MSH Infermieri është mbështetur në modelet e programeve të studimit të ofruara në Universitetet perendimore. Fakti që ky program është mbështetur nga një projekt Erasmus+ në të cilin janë përfshirë si universitete perendimore ashtu edhe rajonale, ka ndikuar në ndërtimin e programeve të ngjashme midis tyre dhe modeleve të vendeve të tjera.¹⁹ Përafrimi i programeve të studimit është pjesë e prioriteteve të UET, i cili aplikohet në të gjithë programet e studimit.</p> <p>Konkretisht, programet janë të organizuara në përputhje me udhëzimet e Ministrisë dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS.</p> <p>Programi aplikohet përgjate dy viteve. Ngarkesa mesatare vjetore është 60 kredite, e ndarë në mënyrë të balancuar mes dy semestrave. Programet ofrohen me kohë të plotë.²⁰</p> <p>Për hartimin e programeve UET ka marrë për bazë programet e ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare.²¹</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të</p>	<p>Programi është hartuar duke ju referuar përvojave më të mira bashkëkohore Europiane dhe të vendase, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës. Kjo gjë është konkretizuar edhe me marrëdhëniet që ka institucioni ynë me institucione të ngjashme</p>

¹⁶ Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32)

¹⁷ Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

¹⁸ Raporti i përfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit (Ref. Nr. 35); Marreveshje bashkepunimi (Ref. Nr. 34.1 – 34.7)

¹⁹ Te dhena mbi projektet, shkembimet, publikimet dhe veprimtaria kerkimore e stafit akademik (seksioni A) (Ref. Nr. 43); Mobility Agreement_IAA_UET-Cordoba (Ref. Nr. 43.1)

²⁰ Plani mësimor (Ref. Nr. 14.1)

²¹ Plani Strategjik 2015-2020, Prioritetet në procesin mësimor, pika 4 (Ref. Nr. 3)

<p>institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>europiane, si dhe me programe të ndryshme. Programi i studimit përmban të gjithë elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit.²²</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Ne vizionin e UET, universitetet duhet të prodhojnë mendje cilësore dhe jo thjesht studentë të mbushur me dije e njohuri, duke i dhënë përparësi kreativitetit individual e kolektiv në shërbim të zhvillimit, duke krijuar mundësi për përvetësimin e njohurive specifike teknike e profesionale që të përgatisin për të ushtruar një profesion të caktuar, që zhvillojnë veti adaptuese me realitetin, që nxisin iniciativën dhe krijimin e punëve apo shërbimeve të reja, etj. Programi i studimit ka marrë në konsideratë kërkesat specifike që ka profesioni i infermieri, i rregulluar në bazë të direktivave kombëtare dhe ndërkombëtare. Kurrikula e programit, krahas përfshirjes së praktikës profesionale si një nga detyrimet akademike të programit, parashikon edhe zhvillimin e lëndëve të tjera praktike të lidhura ngushtë me profesionin. Rregullorja e programit të studimit thekson si një ndër objektivat kryesore të programit aftësimin profesional të studentit.²³ Programi i studimit përfshin aftësim profesional dhe kërkim shkencor. Aftësimi profesional i studentëve realizohet jo vetëm përmes praktikës profesionale, e cila kryhet gjatë semestrit të dytë, por edhe përmes lëndëve me karakter aplikues që ofrohen në programin e studimit.²⁴ Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET-it dhe drejtimet e miratuara për kërkimin shkencor.²⁵</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit e institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MSH infermieri është licensuar në gjuhën shqipe dhe si i tillë programi ofrohet vetëm në këtë gjuhë.²⁶ Gjithsesi, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, UET krijon mundësinë që për studentët Erasmus, lëndë specifike të ofrohen në gjuhë të huaj.</p> <p>UET ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional duke përfshirë edhe programet e studimit për INFERMIERI. Gjithashtu, lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare zhvillohet në kuadër institucional ndaj të dhënat e këtij seksioni do të jepen në nivel insitucional. Aktualisht UET gëzon 95 marrëveshje (memorandum bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë. Nga ana tjetër UET gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare, publike dhe jo publike.²⁷ UET synon organizimin dhe ofrimin e diplomave të</p>

²² Rregullore e programit të studimit (Ref. Nr. 7); Kurrikula e programit të studimit (Ref. Nr. 14); Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

²³ Rregullore e programit të studimit (Ref. Nr. 7);

²⁴ Plani mesimor in dare sipas veprimtarive formuese (Ref. Nr. 14.2); Kurrikula e programit të studimit (Ref. Nr. 14); Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

²⁵ Plani strategjik UET 2021-2025 (Ref. Nr. 3.3); Strategjia e kerkimit shkencor 2021-2025 (Ref. Nr. 3.2)

²⁶ UMASR Nr. 688, date 15.10.2018 “Per hapjen e programit te studimit” (Ref. Nr. 54)

²⁷ Marreveshje bashkepunimi UET (Ref. Nr. 34)

	<p>përbashkëta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët. UET synon përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standarteve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratoreve, etj. UET inkurajon një kulturë të ndarjes së njohurive dhe lidhjet horizontale ndërmjet ILA-ve, OShC-ve, qendrat kërkimore, organizatat qeveritare dhe palëve të interesuara. Si e tillë UET inkurajon dhe mbështet fuqimisht lëvizshmërinë e stafit dhe studentëve në rajon, në Bashkimin Evropian dhe më gjerë.</p>			
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>UET, jo vetem në programet Master, por edhe ato Bachelor, përgatit, ruan dhe arkivon vazhdimisht dokumentacionin dhe aktivitetet e zhvilluara në gjuhën angleze. Keto dokumenta mund të vihen në dispozicion menjëherë pas nevojës së gzykuar për studim apo rishikim të tyre. Dokumentat që nevojiten për këto qëllim, depozitohen dhe janë të aksesueshme në “Dokumenta UET”, nepermjet rrjetit të brendshëm të Universitetit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.4 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Institucioni demonstroi se ka një përvojë pozitive dhe kapacitetet, burimet e duhura në fushën Infermierisë për ofrimin e programit të studimit Master Shkencor në Infermieri. Në Departamentin e Shkencave Mjekësore Teknike pjesa më e madhe e lektorëve janë me tituj dhe grada shkencore, dhe me eksperiencë në fushën e kërkimit shkencor dhe në mësimdhënie. Cilësia e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, janë tregues të përvojës dhe kapaciteteve të duhura në ofrimin e programit MSH Infermieri. Personeli Akademik Efektiv, në nivel fakulteti, përbëhet nga: 2 Professore, 2 Profesorë të Asociuar, 7 Lektorë me gradën Dr./PhD, dhe nga 10 Asistent Lektorë/Doktorantë. Ndërsa Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga 1 Lektor me gradë Dr./PhD dhe 7 Asistent Lektorë.²⁸ Stafit akademik është i kualifikuar, me përvojë dhe i përshtatshëm për ofrimin e programeve në fushën e shkencave mjekësore.</p> <p>Në programin e studimit MSH Infermieri për vitin 2020-2021 janë angazhuar në total 12 staf akademik, prej të cilëve 2 Profesorë, 1</p>

²⁸ Te dhena tabelore për personelin akademik të fakultetit (Ref. Nr. 23); CV e stafit akademik (Ref. Nr. 20)

	Profesorë të Asociuar, 5 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 4 MSC/Doktorantë. ²⁹			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi MSH Infermieri, është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Konstatohet përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Kjo përputhshmëri evidentohet në të gjithë programet e ofruara nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. ³⁰ Programi në fjale përfshihet në një nga Projektet e Mëdha Kërkimore (PMK) që përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET. ³¹ Procesi mësimor dhe ai kërkimor e shkencor zhvillohet sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe në përputhje me normat dhe standardet bashkëkohore të vendeve që bëjnë pjesë në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) ³²			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Departamenti përgjegjës për Programin e studimeve MSH Infermieri, është Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. Fusha akademike e kërkimore e programit të studimit është në përputhje me fushën kërkimore të njësisë bazë. Gjithashtu, fushat e kërkimit shkencor të cilat udhëhiqen nga anëtarët e departamentit apo bëjnë pjesë, janë në përputhje me programin e studimit. Mund të përmendim dy prej tyre <ul style="list-style-type: none"> • Sfidat Demografike dhe Strukturore ndaj Sistemit Shendetesor • Morboziteti Infeksionet Hospitaliere dhe në Njesite e Reanimacionit 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjëse	Ndarja e detyrave dhe përgjegjëse në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit ³³ . Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në aktet rregullatore janë të përcaktuara qartë roli i

²⁹ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabelat 6 (Ref. Nr. 0.2)

³⁰ Te dhena per numrin e programeve qe ofrohen nga njesia pergjegjese (Ref. Nr. 26)

³¹ Strategjia e Kërkimit shkencor 2017-2020, pika 7 (Ref. Nr. 3)

³² Statuti UET, neni 10.1 (Ref. Nr. 2)

³³ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 16, 17, 18, 21, 22 (Ref. Nr. 5); Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref. Nr. 6); Vendim për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit (Ref. Nr. 36)

<p>respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>përgjegjësit të njësisë bazë, përgjegjësit të grup-lëndëve/koordinatorit të programit sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike. Në kuadër të analizës së ecurisë së programit është hartuar dhe një raport paraprak, në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat për në vijim.³⁴</p> <p>Në dokumentin A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, pjesa në lidhje me Hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programit të lëndës, shprehet qartë se programi i lëndës propozohet nga pedagogu titullar i saj dhe diskutohet me pedagogët e grup-lëndëve.³⁵</p> <p>Programi konsultohet nga përgjegjësi i grup - lëndëve përkatëse dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Silabusi i miratuar shoqërohet me formatin e vlerësimit.</p> <p>Pedagogu mund të propozojë shmangie nga formati i miratuar i programit të lëndës, të cilat duhet të diskutohen në grup-lëndë dhe në Departament, të miratohen me vendim të Këshillit të Fakultetit dhe të pasqyrohen në programin e lëndës. Pas miratimit, programi i lëndës, në versionin e tij të shkurtër, vihet në dispozicion të studentëve dhe për publikim. (<i>Versioni i gjatë, i miratuar, depozitohet në Departament dhe është pronë e UET-it</i>).³⁶</p> <p>Përveç ndarjes së detyrave dhe marrjes së përgjegjësi sipas dokumentit që përmban aktet rregullatore të UET, ekzistojnë edhe struktura të tjera me funksion rregullator. Kështu Komisioni i sigurimit të cilësisë në UET ka në fokus edhe analizën e programeve të studimit dhe mund të monitorojë dhe analizojë përmbushjen e standarteve UET.³⁷ Gjithashtu në mbledhjet e Departamentit të cilat zhvillohen një herë në javë mund të diskutohen dhe shkëmbehen ide midis kolegëve të disiplinave të afërta në funksion të përmirësimit në përmbajtje të programit të lëndës.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj³⁸. UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve sin je nder komponentët kryesore, sëbashku me krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit</p> <p>Programi 250+ është krijuar pikërisht për të rritur bashkëpunimin e UET dhe të këtij programi studimi me kompani</p>

³⁴ Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave të programit (Ref. Nr. 38); Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 35)

³⁵ Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (Ref. Nr. 39)

³⁶ Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (Ref.Nr.39)

³⁷ Dokumenti F.VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

³⁸ Marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 34)

	<p>të llojeve të ndryshme. Ky program synon që nëpërmjet bashkëpunimit me këto kompani të bëhet i mundur integrimi i studentëve tanë në internship-e dhe në punësimin e tyre. Ky bashkëpunim synon rritjen e njohurive dhe aftësimin profesional, shkencor e praktik të studentëve që ndjekin këtë program studimi duke patur këto kompani prioritare për të dërguar studentët në praktika profesionale dhe në përfshirjen e drejtuesve të këtyre kompanive në leksione të hapura në programet Master duke përcuar praktikën dhe eksperiencën e tyre tek studentët. Në këtë kuadër UET organizoi javën e hapur sipas Fakulteteve, ku në ditën e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike u prezantuan me perfaqësues të tyre Institucione si Urdhri i Infermierit, kompani si laboratorike, farmaceutike, etj për të vendosur kontakte të drejtpërdrejta të studentëve me aktorët e biznesit vendas si edhe për t'i përditësuar ata me zhvillimet e reja psh. në Urdhrin e Infermierit.³⁹</p>
<p>Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizmin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, janë nënshkruar dhe ka marrëveshje të posaçme me institucione, organizata, kompani, shkolla, klinika psikologjike dhe shume institucione te tjera, për realizimin e praktikave profesionale.⁴⁰ Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale në UET funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila ka lidhur memorandume bashkëpunimi me shumë institucione publike dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione.⁴¹ Krahas rolit të kësaj zyre, studentëve u caktohet një pedagog mbikëqyrës, i cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritës dhe jep vlerësimin e tij në përfundim të kryerjes së praktikës nga ana e studentit. Në të njëjtën kohë pedagogu udheheqës i praktikës krijon në mënyrë të vazhdueshme kontakte për bashkëpunim në mënyrë që të krijohen rrjetëzime efektive për në vazhdimësi. Aktualisht Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka marrëveshje bashkëpunimi me Qëndrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Qendren Spitalore Ushtarake Tirane dhe Spitalin Amerikan. Një pjesë e pedagogëve të lëndëve të programit të MSH Infermieri, kanë mentoruar studentët në vendet e punës ku ata punojnë.⁴²</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Përveç parashikimeve në marrëveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësisive të ndryshme të përfshira në këtë proces.⁴³ Kështu, Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e</p>

³⁹ Te dhena mbi aktivitetet FSHMT – Departamenti I Infermierise dhe Fizioterapise (Ref. Nr. 43.1)

⁴⁰ Marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 34.1 – 34.7)

⁴¹ Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e zyrës se keshillimit te karrieres dhe kujdesit ndaj studentit (Ref. Nr. 12)

⁴² Marreveshje bashkepunimi (Ref. Nr. 34.3; 34.7); ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabelat 12 (Lenda: Praktike Profesionale)

⁴³ Dokumenti B.I Mbi praktiken Profesionale (Ref. Nr. 32.1)

	<p>praktikës. Për realizimin e këtij bashkpunimi, para fillimit të praktikës, pasi është përzgjedhur institucioni se ku do të bëhet praktika, pedagogu udhëheqës merr kontaktet (Nr cel+adresë e-maili) për t'i kërkuar insitucionit që në fund të praktikës studentit gjithashtu t'i bëhet një vleresim, mbi mënyrën se si ka operuar ai gjatë praktikës duke filluar që nga respektimi i orarit të institucionit, bashkpunimi që ka pasur ai me stafin etj. Studenti dorezon një formular (Kodi B.I.3 Formulari i vlerësimit të studentit praktikant) ku ky formular plotësohet nga personi që në këtë rast është supervizuesi i studentit. Gjithashtu, student dorezon formular per vetevleresimin e periudhes se zhvillimit te praktikës⁴⁴.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës ka organizuar përgjatë vitit të parë të tij disa aktivitete dhe trajnime në bashkëpunim me institucione të vendit dhe të ftuar ndërkombëtarë. Përgjate vitit 2020, u zhvilluan leksione te hapura per studentet lidhur me situaten aktuale te Covid 19, duke i mbajtur ata te informuar me protokollet e kohes. Në mars 2019 u organizua trajnimi në formën e një leksioni të hapur demonstrativ me temë <i>Ndihma e parë në Urgjencat mjekësore</i> në bashkëpunim me Qendrën Vullnetare të Emergjencave Civile. Çertifikatat për pjesëmarrësit e trajnimit u firmosën nga Drejtori Ekzekutiv i Qendrës Vullnetare të Emergjencave Civile dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin European të Tiranës.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka organizuar në prill 2019 në kuadër të konferencës Ndërkombëtare të përvitshme që organizohet nga Universiteti European i Tiranës sesionin shkencor të akredituar nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim me me 6 kredite, me temë <i>The knowledge society diagnostics and prognoses</i>, paneli IV dhe V për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike ku u mbajtën 15 prezantime dhe morrën pjesë studentët e Infermierisë dhe Fizioterapisë.</p> <p>Në janar 2018 u organizua një leksion i hapur me të ftuar fizioterapistin Italian Alberto Polidori për të prezantuar teknikën fizioterapeutike Shiatsu.</p> <p>Në dhjetor 2018 u organizua nga Instituti European Pashko në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit European të Tiranës Forumi i Shëndetit Publik 2018 me temë Formimi i personelit mjekësor në Shqipëri: Shkollimi/Specializimi/Kualifikimi.</p> <p>Në tetor 2018 UET zhvilloi një leksion të hapur me temë Eutanazia: Pro-Kundër me të ftuar Prof. Henry Marsh, i cili prezantoi në vijim edhe librin e tij te studentët.⁴⁵</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Në kuadër të analizës së ecurisë së programit është hartuar dhe një raport paraprak, në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat për në vijim. Gjithashtu, fakti që studentët po ndjekin praktikën profesionale në institucionet me</p>

⁴⁴ Dokumenti B.I.3 Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.1); Formulari I vetvlersimit te praktikës (nga student) (Ref. Nr. 32.2)

⁴⁵ Te dhena mbi aktivitetet FSHMT – Departamenti I Infermierise dhe Fizioterapise (Ref. Nr. 43.1)

	<p>të cilët UET bashkëpunon, është një tregues i përfitimit nga marrëveshjet, qofshin të shkruara apo të pa shkruara.⁴⁶</p> <p>Prandaj në fund të çdo viti akademik, në UET praktikat vlerësohen nga një komision i posaçëm dhe nga vetë studentët me anë të një formulari [formati B.1.4] ku merret feedback-u për efektshmërinë e realizimit të tyre, dhe si mund të punohet më tej në përmirësimin e praktikave⁴⁷. Gjithashtu studenti plotëson dhe një raport ku disa nga pikat e rëndësishme të këtij raporti paraqesin dhe rëndësinë që kanë pasur lënde specifike për realizimin e praktikës (apo në formimin profesional të studentit), gjithashtu nepermjet formularit [formati B.1.3] që plotësohet nga supervizuesi i studentit kuptohet nëse ka funksionuar marrëveshja e bashkëpunimit me Institucionin⁴⁸.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>UET vazhdimisht nxit stafin akademik e studentor për kërkime shkencore, ndjek rezultatet e tyre si dhe ofron publikim të punës së tyre në fushën e kërkimit shkencor në revistat prestigjioze që boton, duke e ofruar materialin edhe në gjuhën angleze. Në dekadën e tij të dytë, UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësimdhënie, në një institucion elitare kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET. Për të mbështetur zhvillimin e Kërkimit Shkencor brenda institucionit, UET ka hartuar Strategjinë e kërkimit shkencor në UET (2017-2020; 2021-2025).⁴⁹</p> <p>Në pikën 14, të Strategjinë e kërkimit shkencor në UET theksohet se UET do të vendosë në dispozicion të stafit akademik një fond kërkimor, tek i cili kërkuesit mund të aplikojnë për mbështetje për ndërmarrjen e projekteve kërkimore ose për shpërblym pas publikimit në revista dhe libra të botuara nga shtëpi botuese me reputacion ndërkombëtar në akademi.</p>

⁴⁶ Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave të programit (Ref. Nr. 38); Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 35)

⁴⁷ Dokumenti B.1.4 Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32); Formulari I vetvlersimit të praktikës (nga student) (Ref. Nr. 32.2)

⁴⁸ Dokumenti B.1.3 Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32)

⁴⁹ Ditët e Studimeve Shqiptare (Ref. Nr. 55); Te dhëna mbi projektet, shkëmbimet, publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik (Ref. Nr. 43); ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 19, Tabela 22

<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>UET ka hartuar Strategjinë e kërkimit shkencor në UET (2017-2020; 2021-2025). Kjo strategji detajon objektivat dhe instrumentat që do të përdorë UET për të strukturuar, përparuar, standardizuar dhe ndërkombëtarizuar kërkimin shkencor. Duke u bazuar në pikën 4.2., drejtimi strategjik i kërkimit shkencor bëhet nga Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor, Metodologjinë, dhe Cilësinë në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Studimeve Doktorale si dhe Senatit Akademik të cilët monitorojnë dhe vlerësojnë ndërtimin e SKSH-së me një vizion afatmesëm dhe afatgjatë, mbikëqyrin zbatimin e saj dhe përditësojnë prioritetet e kërkimit shkencor në përputhje me synimet e UET. Ekziston një grup individesh të ngarkuar me vlerësimin e ecurisë së rezultateve të kërkimeve shkencore. Kërkimet shkencore të realizuara nga stafi apo studentët udhëhiqen nga profesioniste me titull të grada shkencore.⁵⁰</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Çdo dy vjet në UET, realizohet follow up me stafin akademik mbi publikimet dhe aktivitetin e tyre shkencor (pika 5.2, Strategjinë e kërkimit shkencor në UET (2017-2020; 2021-2025). Duke iu referuar, pikës 12, nxiten që pedagogët me gradën PhD e lart të botojnë të paktën një artikull shkencor çdo tre vjet në një revistë me faktor impakti të listuar në Thomson Reuters ose në Scimago Journal & Country Rank (SCOPUS, ElsevierB.V.). Gjithashtu, nëpërmjet financimeve që UET ofron (pika 14, Burimet) nxit promovimin e kryerjes së kërkimit shkencor. Rezultatet në fushën e kërkimit shkencor studiohen dhe nxirren në publikimet e universitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>UET për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të pronësisë intelektuale, ka të përcaktuar në nenin 33, të Rregullores mësimore të UET, për procedurat që ndiqen, në rastin e plagjiaturës. Në seksionin B.II.7, të Broshurës së Dokumentave UET, parashikohet që çdo student që citon veprën e dikujt është i detyruar të citojë autorin si dhe vitin e botimit të veprës. Instalimi I sistemit të antiplagjiaturës Turnitin Ephorus, ndihmon që studentët të mos kryejnë punime plagjiaturë. Çdo publikim, çdo kërkim shkencor i realizuar dhe udhëhequr nga pedagogët e UET, mbrohet si pronësi intelektuale në përputhje edhe me legjislacionin në mbrojtje të të drejtave të autorit në kërkime dhe publikime.⁵¹</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Një ndër objektivat kryesor të programit të studimit të MSH Infermieri, është të pajisë studentin me aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, zakonisht realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me pedagogët e tyre. Format e bashkëpunimit, mund të jenë përfshirja e studentëve në punën kërkimore të</p>

⁵⁰ Strategjia e kërkimit shkencor UET (Ref. Nr. 3.1, 3.2)

⁵¹ Rregullore UET (Ref. Nr. 5); Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomes dhe disertacionit (Ref. Nr. 10)

	pedagogut, prezantimi në konferenc shkencore si DSSH apo detyrat e kursit. ⁵² UET mbështet doktorantët e rinj, duke iu ofruar bursa studimi për studimet e ciklit të tretë, por edhe nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme (Trajnime për Doktorantë – Certificate of Beginning) për t’i mundësuar doktorantëve përfundimin e aftësive të nevojshme për të qenë kërkues të suksesshëm dhe kontribues aktivë në jetën akademike të UET. Gjithashtu edhe studentet nxiten për t’iu shtruar punës për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor, sidomos në programe të ciklit të dytë siç është MSH në Infermieri. Puna kërkimore shkencore është një nga qëllimet e UET, i cili inkorporon në programet e studimeve gjithnjë lende që thellojnë me tepër formimin e studentit dhe përgatitjen e tyre në këto drejtim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE

Standardi II.1	
Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit në Master Shkencor “Infermieri” është i organizuar në lëndë e module të cilat janë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MASR, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i shtrirë në 2 vite, ngarkesa mesatare vjetore është 60 kredite, totali 120, e ndarë në mënyrë të balancuar midis dy semestrave ⁵³ . Lëndët e këtij programi janë të vlerësuara me nga 6 kredite (ECTS) dhe praktika profesionale/internship-i me 12 kredite (ECTS), ndërsa punimi i diplomës vlerësohet me 18 kredite. Programet ofrohen me kohë të plotë dhe diplomat e lëshuara janë të akredituara nga MASR sipas legjislacionit në fuqi.

⁵² Rregullore e programit të studimit (Ref. Nr. 7); Silabuset e lendeve (Ref. Nr. 19); ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 22

⁵³ Kurrikula e programit MSH Infermieri, (Ref. Nr. 14) ; Plani mesimor (14.1)

<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar dhe realizohet konform misionit dhe qëllimit të institucionit. Ai synon të formojë specialistë në fushën e Infermierise, duke i vënë një theks të veçantë njohurive dhe kompetencave në këtë fushë. Ky program synon formimin praktik, për arritjen e objektivave shkencore, me qëllim punësimin ose kualifikimin në një pozicion pune infermior apo thellimin drejt studimit apo mbrojtjes së temave shkencore⁵⁴.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në fusha specifike të studimit dhe këto njohuri jepen në mënyrë mjaft të qartë nëpërmjet lëndëve të profilit të cilat janë të ndryshme në secilin vit. Përgjithësisht të gjithë lëndët janë ato lëndë të cilat i vijnë në ndihmë të drejtëpërdrejtë studentit duke përfutur njohuri të avancuara dhe efektive për ushtrimin e profesionit në momentin që del në tregun e punës.</p> <ol style="list-style-type: none"> Përmbajtja e njohurive në programet e ciklit të dytë të studimeve janë të përqëndruara: Paraqitja kryesisht e një informacioni teorik bashkëkohor në kuadrin e disiplinës, shqyrtuar sipas një problematike të përcaktuar; Probleme empirike të realitetit të sotëm të huaj dhe vendas; Aplikimi metodologjik i teorive të ndryshme në praktikën e drejtimit dhe të administrimit të institucioneve ose të ndërveprimit institucional etj. <p>Këto dhe objektiva të tjera janë mbështetur në pikën A.III.4.2.1 të dokumentit “Mbi parimet e ndertimit të programit të lëndes”.⁵⁵</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike dhe profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme. Të punuarit me pacientë është gjithmonë një situatë sfiduese dhe kërkon nivel të lartë përgjegjshmërie. Duke u nisur nga disa aftësi specifike dhe të domosdoshme që duhet t’i ketë profesionisti i ardhshëm, Masteri i shkencave në “Infermieri”, e përgatit studentin për t’u përballur me situata komplekse por dhe ato të paparashikuara. Lëndët janë specifike sipas semundjeve të specialiteteve të ndryshme, ka lëndë multidisiplinare si Infermieristika e Semundjeve të brendshme, Infermieristika kirurgjikale e avancuar, Infermieristika në urgjencat mjekesore, Kujdesi infermior në salla si edhe lëndë diagnostike dhe laboratorike të cilat e përgatisin studentin për tu orientuar drejt diagnozave infermiore dhe ndërhyrjeve të mundshme.⁵⁶</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave” /“Master i Arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015, (neni 75). Programi ofrohet me 120 ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Studimet përmbillen me provim përfundimtar formimi, ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave”⁵⁷. Rregullorja mësimore e programit të studimit “Master i shkencave” mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015</p>

⁵⁴ Rregullore e programit të studimit (Ref. Nr. 7);

⁵⁵ Dokumenti A.III Mbi parimet e ndertimit të programit të lëndes (Ref. Nr. 39)

⁵⁶ Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

⁵⁷ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 3.1 (Ref. Nr. 7)

	<p>“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit European të Tiranës. Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Kjo rregullore përcakton aspektet organizative të programit. Ajo është hartuar duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave” / “Master i Arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programet e studimit i kanë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese. Lëndët në përmbajtje të kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive (A-E), me peshën e përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL.” Çdo program studimi rregullohet me rregullore të veçantë të programit të studimit ku në mënyrë më specifike programet e studimit organizohen në 5 kategori disiplinash⁵⁸:</p> <p>Kategoria A: Lëndë bazë - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</p> <p>Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore</p> <p>Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.</p> <p>Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.</p> <p>Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues.</p> <p>Si pjesë e lëndëve të kategorisë C, departamenti mund të ofrojë lëndë “<i>Honors course</i>”. Këto lëndë propozohen dhe drejtohen nga pedagogë me grada dhe tituj, të cilat mund të ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin, në varësi të ekspertizës së personelit akademik të gatshëm për t’i zhvilluar. Këto kurse mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze.</p> <p>Studenti merr 12 kredite në Kategorinë A, 60 kredite tek B, 18 kredite tek C, 12 në kategorinë D, dhe 18 kredite ka detyrimi përmbyllës (E), i cili është provim përfundimtar, ose punim diplome. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p> <p>Për cikle leksionesh/module brenda lëndëve të programit, mund të ftohen edhe ekspertë, personalitete të njohur të fushës.</p> <p>Bazuar në mënyrën e organizimit të mësimit dhe formës së kontrollit të dijeve, lëndët ndahen në 2 tipologji:</p> <p>a. Lëndë të Tipologjisë I konsiderohen lëndët me karakter kryesisht praktik/aplikativ.</p>

⁵⁸ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, (Ref. Nr. 7)

	b. Lëndë të Tipologjisë II konsiderohen lëndët me karakter kryesisht teorik. Çdo program studimi organizohet bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe në përputhje me filozofinë dhe objektivat e UET-it. ⁵⁹			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Në programin e studimit, punimi i diplomës ndodhet në kategorinë E “Detyrime Përmbyllëse” dhe ka 18 ECTS. ⁶⁰ Në dokumentin B. II, <i>Mbi punimin e diplomës</i> , janë të përcaktuara qartë procedurat e zhvillimit të diplomës. ⁶¹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Për përmbushjen e vlerësimit dhe akreditimit është përgatitur nga një Grup ekspertësh (më poshtë do të quhet Grupi) i ngritur posaçërisht për hartimin e tij me Urdhër të Rektorit të UET-it. Grupi i ngritur me Urdhër të Rektorit, Nr.15, datë 21/12/2020, në përputhje me zbatimin e kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 104, në mbështetje të Statutit të Universitetit Europian të Tiranës, pika 20.3.4, gërma “m”. Gjithashtu UET i ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar dhe riakredituar në nivel institucional. ⁶² Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe KSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anetarëve të Bordeve të Tregut të Punës si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, i cili është përgjegjës për programin MSH Infermieri, përmbush detyrimet ligjore sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 për të ofruar programin e studimit Master Shkencor në Infermieri, si edhe për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

⁵⁹ Silabuset e lendeve, seksioni Kontrolli i vazhdueshem (Ref. Nr. 19)

⁶⁰ Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref.Nr.10)

⁶¹ Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref.Nr.10)

⁶² VBA Nr. 12, date 07.04.2018 (Ref. Nr. 54.2); VBA Nr. 46, date 05.07.2019 Per akreditimit e UET (Ref. Nr. 54.4); Certificate akreditimit UET (Ref. Nr. 54.5)

	<p>është i përbërë nga dy Departamente dhe Qendra e kërkimit shkencor në Shëndet Publik përkatësisht: Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Departamenti i Imazherisë dhe Qendra e kërkimit shkencor në Shëndet Publik.⁶³ Afati normal për përfundimin e studimeve në Masterin Shkencor Infermieri është 2 (dy) vite akademike.</p> <p>Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përbëhet nga 11 anëtarë të personelit akademik, 7 të brendshëm, nga të cilët 3 me grada dhe tituj. Departamenti organizohet në Grup-lëndë, ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grup-lëndëve. Departamenti zhvillon mbledhjet e zakonshme çdo të Martë.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar⁶⁴.</p> <p>Titullarët e lëndëve në MSH Infermieri, kanë të paktën gradën Dr. Për vitin akademik 2018-2019, kanë qenë të angazhuar në total 9 anëtarë të stafit akademik nga të cilët 3 mbajnë titullin Prof. Dr., 1 mban titullin Prof. Asoc. Dr., 5 kanë gradën Dr. 8 prej tyre janë personel me kohë të plotë dhe 1 prej tyre me kohë të pjesshme⁶⁵. Për vitin akademik 2019-2020, kanë qenë të angazhuar në total 12 anëtarë të stafit akademik nga të cilët 7 mbajnë titullin Prof. Dr., 3 kanë gradën Dr., 1 është Doktorant dhe 1 Msc. 7 prej tyre janë personel me kohë të plotë dhe 5 prej tyre me kohë të pjesshme⁶⁶. Për vitin akademik 2020-2021, kanë qenë të angazhuar në total 12 anëtarë të stafit akademik nga të cilët 2 mbajnë titullin Prof. Dr., 1 mban titullin Prof. Asoc. Dr., 5 kanë gradën Dr., 1 është Doktorant dhe 1 Msc. 9 prej tyre janë personel me kohë të plotë dhe 3 prej tyre me kohë të pjesshme⁶⁷. Raporti i numrit të personelit akademik me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesshme, në 2020-2021 është 75% / 25%. Pedagoget e angazhuar kanë përvojë të gjatë akademike dhe si mjekë klinikistë. Të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar në programin MSH Infermieri kanë dhënë lëndë në përputhje me fushën e tyre të specializimit – Tabelat nr. 12 në dokumentin Aneks: Tabelat përmbledhese (Ref. Nr. 0.2) specifikon specializimin mjekësor/ekspertizën e secilit pedagog krahas lëndës si titullar. Këto të dhëna dëshmojnë nivelin e lartë akademik të stafit të angazhuar.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike sipas kriterit 2 të po këtij standarti.⁶⁸</p>

⁶³ ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 1 (Ref. Nr. 0.2)

⁶⁴ Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2 (Ref. Nr. 6)

⁶⁵ ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 6.1 (Ref. Nr. 0.2)

⁶⁶ ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 6.2 (Ref. Nr. 0.2)

⁶⁷ ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 6.3 (Ref. Nr. 0.2)

⁶⁸ Ligji Nr. 80/2015 Neni 23, pika 2 (Ref.Nr. 53); ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 1 dhe Tabelat 2 (Ref. Nr. 0.2)

nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.									
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Për realizimin e praktikave është përgjegjës Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe pedagogu që caktohet për t'i ndjekur ato ⁶⁹ . Në ciklin e dytë të studimeve, studenti krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion/organizatë/kompani i mbikqyrur nga pedagogu përgjegjës, i caktuar në rolin e Këshilluesit të karrierës. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka marrëveshje me struktura spitalore për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. Aktualisht marrëveshjet e bashkëpunimit janë me Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Qendren Spitalore Ushtarake Tirane dhe Spitalin Amerikan. Praktikrat mbikëqyren nga një pedagog i departamentit, si edhe nga personi përgjegjës në insitucionin/kompaninë ku zhvillohet praktika.								
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UET, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë ka një koordinator për secilin nga programet e ofruara. Në bazë të vendimit Nr. 97, datë 03/ 12 /2020, koordinatoor për programin MSH Infermieri, është Ismet Nika, i cili është përgjegjës për ecurinë e programit dhe informon vazhdimisht Përgjegjësën e Departamentit. Detyrat kryesore të koordinorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET ⁷⁰ .								
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Në bazë të vendimit Nr.95, datë 03/12/2018, koordinator për programin MSH Infermieri është MSc. Anisa Hoxha, e cili është përgjegjës për ecurinë e programit dhe informon vazhdimisht Drejtuesin e Departamentit. ⁷¹								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit studimor. Për këtë gjithashtu vjen në ndihmë dhe rregullorja mësimore e programit të studimit MSH në “Infermieri”. Në këtë dokumentacion paraqiten qartë që nga parimet e përgjithshme, struktura e programit mësimor deri tek shpallja e rregullores së programit të studimit dhe zbatimi i saj.

⁶⁹ B.I. Mbi praktikën profesionale, pjesë e Broshurës së Dokumenteve, (Ref. Nr. 32.1); ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabelat 12 (Pedagogu i praktikës profesionale) (Ref. Nr. 0.2)

⁷⁰ Vendimi i emërimit të koordinorit të programit (Ref. Nr. 36); Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit (Ref. Nr. 6)

⁷¹ Vendimi për emërimin e Koordinatorit (Ref. Nr. 36)

	<p>Gjithashtu, Koordinatorja e Programit të studimit, disponon informacionet e nevojshme, në lidhje me strukturën, përmbajtjen e programeve. Koordinatorja e zotëron këtë informacion në versionin hard dhe soft copy pasi dorëzohen nga ana e personelit akademik që në fillim të semestrit. Nderkohe, i gjithë informacioni në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit, gjenden të publikuara në intranetin e Dokumenta UET. Departamenti dhe çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ, ka akses të plotë jo vetëm tek Statuti e rregullorja e institucionit, por edhe tek kurrikula e programeve të studimit, planet mësimore, silabuset, rregulloret e programeve të studimit, si edhe aktet e tjera rregullatore të UET. Çdo fillim semestri studenteve u vihet në dispozicion programi i lëndëve që ofrohen (silabuset). Këto programe u dërgohen elektronikisht nga koordinatori e departamentit, si dhe gjenden të printuara në librarinë e universitetit. Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Silabuset dhe materialet e leximit për secilën lëndë hidhen edhe në sistemin LMS. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në rregulloren mësimore të UET, Neni 16 Organizimi i programeve të studimit, pika 16.2, shkruhet se bazuar në rolin që çdo disiplinë mësimore ose veprimtari formuese luan në formimin e studentit, programet e studimit organizohen në 5 kategori disiplinash⁷²:</p> <p>Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</p> <p>Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore</p> <p>Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.</p> <p>Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.</p> <p>Kategoria E: Detyrime përmblylëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues⁷³</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të cilat janë të vlerësuara me kredite sipas sistemit evropian te transferimit te krediteve (ECTS). Referim ne shtojcë Programi i Studimit Master Shkencor “Infermieri”⁷⁴. (Pika 3.1 dhe 4 ne Rregulloren Mësimore të Programit Të Studimit Master Shkencor “Infermieri”.</p>

⁷² Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 16 pika. 16.2. (Ref. Nr. 5)

⁷³ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 16, pika 16.2 (Ref. Nr. 5); Kurrikula e programit (Ref. Nr. 14)

⁷⁴ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 3.1 dhe pika 4 (Ref. Nr. 7)

	Kohëzgjatja e studimeve është 2 (dy) vite akademike, i ndarë në 4 semestra. Studentët diplomohen me së paku 120 kredite ECTS ⁷⁵ .
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Informacioni i ofruar për programet e studimit, me lëndët përbërëse të tyre, sipas viteve dhe semestrave janë të publikuara në faqen e internetit të UET-it. ⁷⁶ Plani mësimor i program jep informacion të plotë në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. ⁷⁷ Ndërkohë në rregulloren e UET dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohen rregullat për nivelin e frekuentimit të mësimit (80%) në rastin e programeve të ciklit të dytë, dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. ⁷⁸ Gjithashtu studenteve për çdo lëndë u kalohet në sistemin LMS çdo sillabus, ku studentet kanë aksesin e tyre personal. Një mbledhje e departamentit në muaj është e hapur për studentët, ku diskutohen aspekte të procesit mësimor ngushtësisht të lidhura me jetën studentore dhe ku studentët mund të shprehin mendimin e tyre për çështje të programit, rregullores, apo propozime për përmirësim.
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në Rregulloren e programit të studimit parashikohen në pikën 2 “Pranimi në programin e studimit” detaje në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit. Po ashtu dhe në pikën 9 të këtij dokumenti përcaktohet procedura dhe kriteret për transferimin e studimeve. Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluar në një IAL/program të mëparshëm studimi rregullohet me dokumentin D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve. ⁷⁹ I gjithë informacioni në lidhje me Pranimin e Studentëve në Programet e Studimit është i paraqitur në Rregulloren Mësimore Të Programit të Studimit Master Shkencor në UET pika 2 “Pranimi në Programin e Studimit” ku shkruhen të gjitha kriteret e lidhura me pranimin e studentëve dhe në pikën 9 “Transferimet” po tek Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit MSH. ⁸⁰
Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Informacioni i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në silabusin e detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i grup lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Silabuset hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse (Shtojca Nr. 2 e VKM Nr. 41, datë 24.01.2008 “Për elementët e programeve të studimit” dhe Dokumentit A.III. Mbi parimet e ndertimit të programit të lëndës) ⁸¹ Programet mësimore japin informacion mbi njohuritë tematikore, shoqëruar me literaturën bazë apo të detyruar dhe plotësuese apo

⁷⁵ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 3.2 (Ref. Nr. 7)

⁷⁶ <https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/10/Msc.-Infermieri.pdf>

⁷⁷ Plani mesimor i programit (Ref. Nr. 14.1)

⁷⁸ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 3.1 (Ref. Nr. 7)

⁷⁹ Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve (Ref. Nr. 28)

⁸⁰ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 2 dhe pika 9 (Ref. Nr. 7)

⁸¹ Mbi parimet e ndertimit të lëndës (Ref. Nr. 39); VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar (Ref. Nr. 53.1)

	<p>ndihmëse. Programi i lëndës evidenton ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS. Ai tregon format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën. Syllabuset e çdo lënde janë të depozituara dhe mbahen nga personeli administrativ i programit apo koordinatorja⁸². Gjithashtu, ato u vendosen studentëve në dispozicion nëpërmjet sistemit LMS (Learning Management System). Syllabuset e lëndëve të programit të studimit janë pjesë e dosjes me dokumentacionin mbështetës që shoqëron këtë raport.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, pika 10, parashikohet se Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Rishikimi bëhet në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme. Pra përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim të vazhdueshëm. Vlen të theksojmë se në UET përpara fillimit të vitit akademik organizohen takime pune për të vlerësuar çfarë ka nevojë të përmirësohet për vitin në vijim dhe ndryshimet e nevojshme në dokumentacionin. Ndryshimet zakonisht bëhen me qëllim që të sigurohet një cilësi sa më e mirë e programeve që zhvillohen në përputhje me kurrikulën.</p> <p>Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të njëjësive bazë, departamenteve. Çdo anëtar i departamentit ka të drejtë të bëjë propozime dhe të argumentojë përpara kolegëve ndryshimet e propozuara. Nëse vendimi miratohet në nivel departamenti kalon për miratim në instancat më të larta të Këshillit të Fakultetit e më pas në Senatin Akademik, ndryshimet gjithashtu arkivohen në një dosje të plotë.</p> <p>Përmirësimi apo përditësimi bëhet dhe në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Kreu IV neni 35.</p> <p>Sikurse u përmend edhe më sipër, silabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave” /“Master</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Për programin e</p>

⁸² Mbi parimet e ndertimit te lendes pika A.III.5.1 (Ref.Nr.39); Silabuset e lendeve (Ref. Nr. 19)

<p>i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>studimit të ciklit të dytë MSH Infermieri, ngarkesa totale në audior dhe për punë të pavarur në orë mësimore, pasqyrohet në planin mësimor⁸³. Studimet në UET, të ciklit të dytë “Master Shkencor” në Infermieri, ofrohet me 120 kredite ECTS dhe kane kohëzgjatje normale 2 vite akademike te organizuar në 4 semestra (Referuar Pika 3.2.1, Rregullore Mësimore MSH) gje qe është në përputhje me nenin 75, pika 6, të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili përcakton se programet shkencore organizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.⁸⁴</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësi për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e rezultateve të të nxënit e njohurive teorike bazë të fushës së studimit me qëllim punësimin. Emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, u mundëson thellim të njohurive dhe/ose aftësi të nevojshme për punësimin e studentëve.⁸⁵ Ky kriter sqarohet dhe në Statutin e UET i Miratuar nga ish Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, Lindita Nikolla ku sipas këtij Statusi: Programet e studimeve “Master shkencor” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara shkencore. Masteri Shkencor ne Infermieri është hartuar dhe realizohet konform misionit dhe qëllimit të institucionit; Ai synon të formojë profesioniste në fushën e Infermierise, duke i vënë një theks të veçantë njohurive dhe kompetencave që hyjne me thelle ne kete fushe. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht shkencor e praktik, për arritjen e objektivave te programit, njohuri teorike bazë të fushës së studimit me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë.⁸⁶ (Referuar, Pika 3, Programi i Studimit, Rregullore Mësimore MSH).</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program studimi, dhe kreditet për secilën prej tyre mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Organizimi i veprimtarisë mësimore për Masterin Shkencor në Infermieri shtrihet në 2 (dy) vite e 4 semestra me kohëzgjatje normale 14 javë ⁸⁷. Studimet në këtë cikël janë së paku me 120 ECTS, te ndara për çdo semestër, konform legjislacionit në fuqi. Kjo ndarje, mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit ⁸⁸.</p>

⁸³ Plani mesimor i programit (Ref. Nr. 14.1)

⁸⁴ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 3.2.1 (Ref. Nr. 7)

⁸⁵ Statuti UET, neni 32 pika 4 (Ref. Nr. 2)

⁸⁶ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 3 (Ref. Nr. 7)

⁸⁷ Kalendari akademik (Ref. Nr. 10.3)

⁸⁸ Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese të programit (Ref. Nr. 38)

	Gjithashtu, kontrolli i vazhdueshëm, detyrat praktike gjatë seminarit, rrisin mundësinë për të kuptuar nëse studentët po i arrijnë objektivat mësimore.
Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe është i përafërt gjithashtu dhe me programe të ngjashme ndërkombëtare. Studimet në UET, në të gjitha ciklet e studimit, janë me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës. ⁸⁹
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Për të mundësuar arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve, programi i studimit ofron një ndërthurje midis formimit teorik dhe praktike, duke u bazuar edhe në praktikat më të mira të universiteteve të huaja duke mundësuar në këtë mënyrë edhe transferim dhe mobilitet të studimeve.</p> <p>Bazuar në rolin që çdo disiplinë mësimore ose veprimtari formuese luan në formimin e studentit, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja.</p> <p>a.Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;</p> <p>b.Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;</p> <p>c.Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;</p> <p>d.Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;</p> <p>e. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.⁹⁰</p> <p>Zyra e Projekteve, e cila është përgjegjëse për mobilitetin e studentëve ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë.</p> <p>Programi i studimit Master Shkencor në Infermieri i jep mundësi studentëve të punojnë në sektorë publike dhe jo-publikë me akses të drejtpërdrejtë në tregun e punës.</p>
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar	Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Është mjaft e rëndësishme të theksohet se në

⁸⁹ Silabuset e lëndëve (Ref. Nr. 19)

⁹⁰ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 16, pika 16.2 (Ref. Nr. 5)

<p>në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>UET behet një përzgjedhje mjaft specifike e literatures qoftë e asaj bazë qoftë e literaturës ndihmëse. Përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e Grup-Lëndëve, shqyrtojnë silabuset e lëndëve që zhvillohen gjatë secilit semestër me synimin që literatura bazë dhe e rekomanduar e përfshirë në Silabus të datojë jo më e vjetër se 5 (pesë) vitet e fundit.⁹¹ (referuar, pikës 6 të Indikatorët Kryesorë të Performancës së Përgjegjësit të Departamentit, Urdhër Administrativ, Nr.02.Prot, datë 22.01.2014 Mbi indikatorët e Dekanit dhe Përgjegjësit të Departamentit’.)</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi është ndërtuar duke mbështetur misionin e UET për një edukim cilësor dhe forcimit të dijeve të qëndrueshme. Ai kombinon teorinë dhe praktikën duke synuar nxitjen e studentëve për përvetësimin e dijeve bashkëkohore. Programi i studimit mbështetet nga një staf akademik cilësor dhe shumë i përgatitur në kontekstin e mësimdhënies dhe didaktikave mësimore që përdor për të nxitur të mësuarin me baza të shëndosha dhe nxitjen e mendimit krijues dhe shkencor të studentët. Programi ka një kontekst bashkëkohor dhe mbështetet nga kurrikula që evidentojnë dukshëm shërbimin më të mirë ndaj kërkesave aktuale për formimin në këtë disiplinë.</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale, me qëllim kualifikimin dhe punësimin, në fushën e infermierise. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Masteri Shkencor në “Infermieri” është hartuar dhe realizohet konform misionit dhe qëllimit të institucionit, ai synon të formojë specialistë në fushën e Infermierise, duke i vënë një theks të veçantë njohurive dhe kompetencave që lidhen me këto drejtime. Programi i studimit është hartuar duke pasur në konsideratë zhvillimin ekonomik dhe perspektivën e tregut të punës në Shqipëri.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë realizon mbledhje me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës dhe merr në konsideratë mendimet, propozimet dhe konsultohet me ta, për përmirësimin e programit të studimit si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.</p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Ne UET, realizohen vazhdimisht veprimtari të formimit teorik e shkencor, duke bere te mundur aftesimin me njohuri te avancuara per studime, analiza, mbrojtje temash, thellim ne kerkime shkencor duke vijuar me ciklet te trete studimi</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

⁹¹ Dokumenti A.III, pika A.III.12.2. (Ref. Nr. 39)

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Të gjithë anëtarët e personelit akademik, të angazhuar në procesin e mësimdhënies, me kohë të plotë dhe të pjesshme, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada dhe tituj, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. Ky personel në programet e ciklit të dytë realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me Universitetin Europian të Tiranës.</p> <p>Personeli akademik gëzon status të veçantë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si edhe në aktet rregullatorë të UET. Personeli akademik në UET kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UET, këshillim për studentët, tutoriat si dhe veprimtari të tjera.</p> <p>Shpërndarja e lëndëve bëhet duke pasur parasysh që anëtari i personelit akademik të mos zhvillojë më shumë se dy lëndë në semestër dhe jo më shumë se dy lëndë në të njëjtin program studimi.⁹² (Pika G.II, Mbi kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore Broshura e dokumenteve në zbatim të statutit dhe të rregullores bazë të UET-it). Ngarkesa mësimore që mbulon personeli akademik efektiv në programin e studimit dhe personeli akademik me kontratë, pasqyrohet në Aneks: Tabelat përmbledhëse – Tabelat 12.⁹³</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” / “Master i Arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i njëjësive bazë i përgjigjet si kërkesave ligjore ashtu edhe nevojave të institucionit për të mbuluar ngarkesën mësimore të programeve të studimit. Personeli akademik i Fakultetit i Shkencave Mjekesore Teknike përbëhet nga 21 anëtarë të angazhuar me kohë të plotë, prej të cilëve 11 janë me grada dhe tituj akademikë, nga të cilët 7 anëtarë (3 me grada e tituj Prof. Asoc. Dr., Prof. Dr., Dr.) i përkasin Departamentit të Infermierise dhe Fizioterapise që është edhe departamenti nga buron Programi Masterit Shkencor në “Infermieri”, 7 anëtarë Departamentit të Imazherisë dhe 7 anëtarë Qendrës së Kërkimeve Shkencore në Shëndet Publik. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit, si titullarë të lëndëve apo moduleve janë pedagogë me grada e tituj. Për vitin akademik 2018-2019, kanë qenë të angazhuar në total 9 anëtarë të stafit akademik nga të cilët 3 mbajnë titullin Prof. Dr., 1 mban titullin Prof. Asoc. Dr., 5 kanë gradën Dr. 8 prej tyre janë</p>

⁹² Dokumenti G.II. Mbi parimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore (Ref. nr. 11)

⁹³ ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabelat 12.1; 12.2; 12.3

	<p>personel me kohë të plotë dhe 1 prej tyre me kohë të pjesshme⁹⁴. Per vitin akademik 2019-2020, kane qene te angazhuar ne total 12 anëtarë të stafit akademik nga të cilët 7 mbajnë titullin Prof. Dr., 3 kanë gradën Dr., 1 është Doktorant dhe 1 Msc. 7 prej tyre janë personel me kohë të plotë dhe 5 prej tyre me kohë të pjesshme⁹⁵. Per vitin akademik 2020-2021, kane qene te angazhuar ne total 12 anëtarë të stafit akademik nga të cilët 2 mbajnë titullin Prof. Dr., 1 mban titullin Prof. Asoc. Dr., 5 kanë gradën Dr., 1 është Doktorant dhe 1 Msc. 9 prej tyre janë personel me kohë të plotë dhe 3 prej tyre me kohë të pjesshme⁹⁶.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve.</p> <p>Pjesa kryesore e pedagogëve të angazhuar në zhvillimin e programit të studimit janë pedagogë me grada dhe tituj.</p> <p>Përzgjedhja e pedagogëve që do të japin një lëndë të caktuar realizohet bazuar në ekspertiza akademike dhe kërkimore të pedagogut, përvojës në fushën e mësimdhënies (Pika G.II, Mbi kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore Broshura e dokumenteve në zbatim të statutit dhe të rregullores bazë të Uetit) Si rregull, anëtari më i kualifikuar i personelit akademik mbulon lëndën/lëndët që kanë lidhje më të drejtpërdrejtë me specifikat e programit përkatës.⁹⁷ (Pika G.II, Mbi kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore Broshura e dokumenteve në zbatim të statutit dhe të rregullores bazë të Uetit).</p> <p>Të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar në programin MSH Infermieri, kanë dhënë lëndë në përputhje me fushën e tyre të specializimit. Lënda Infermieristike kirurgjikale e avancuar ka si titullare një pedagog me gradë Prof. Dr. me specializim anestezi, Lënda Infermieristike e Sëmundjeve të Brendshme është dhënë nga një pedagog me titullin Prof. Dr. me specializim mjek kardiolog e sot jepet nga Prof. Asoc. Dr. me specializim anestezi, lënda Farmakologji klinike nga një pedagog me gradën Prof. Dr. anestezist reanimator, lënda Infermieristike e mjekësisë materno-infantile dhe shëndetit riprodhues nga një infermier me titull Dr., Lënda Infermieristike në geriatri dhe mjekësi palliative nga një pedagoge me gradën Dr. me specializim ne Shendet Publik, lënda Infermieristike ne urgjencat mjekesore nga një pedagog me gradën Prof.Dr. me specializim kardiologji si dhe nga një infermiere Msc., ndersa sot nga Prof. Dr. me specializim anestezi si dhe nga një infermiere Msc., lënda Kujdesi infermior në sallë nga një infermier me gradën Dr., lënda Djegie dhe Infermieristike nga një pedagog me gradën Prof.Dr. me specializim kardiologji si dhe nga një infermiere Msc., lënda Diagnoze imazherike nga një imazherist e me pas imazheriste me titull Prof. Dr., lënda Mjekesi familje nga Dr. me specializim kirurg e sot nga Prof. Asoc. Dr.</p>

⁹⁴ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 6.1 (Ref. Nr. 0.2)

⁹⁵ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 6.2 (Ref. Nr. 0.2)

⁹⁶ ANEKS: Tabelat permbledhese – Tabela 6.3 (Ref. Nr. 0.2)

⁹⁷ Dokumenti G.II. Mbi parimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore (Ref. nr. 11)

	<p>anestezist dhe lënda Mjekësi laboratorike nga një biokimist me gradën Dr. e sot nga nje biokimiste me graden Dr.⁹⁸</p> <p>Në bazë të ekspertizës së tyre, anëtarët e departamentit janë përfshirë në Projektet e Mëdha Kërkimore (PMK) që përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET, si senior research apo si anëtarë të këtyre grupeve.⁹⁹ (Strategjia e Kërkimit Shkencor 2017-2020; 2021-2025). Disa nga drejtimet kërkimore që udhëhiqen nga anëtarë të grup-lëndës së Infermierisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sfidat Demografike dhe Strukturore ndaj Sistemit Shendetesor • Morboziteti Infeksionet Hospitaliere dhe ne Njesite e Reanimacionit • Aplikimi i Sistemit te Mjekut te Familjes
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale në UET funksionon Zyra e Karrierës, e cila ka lidhur memorandume bashkëpunimi më shumë institucione publike dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm më ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione dhe për të ftuar ekspertë të fushës në auditor.</p> <p>Departamenti përzgjedh ekspertët e fushës të cilët do të referojnë në auditor në seancat e programuara për programin e studimit. Mbikëqyrja dhe ndjekja e seancave kryhet nga një pedagog, i caktuar nga departamenti i cili ka edhe statusin e këshilluesit të karrierës. Pedagogu këshillues i karrierës, shpërndan dhe mbledh dokumentacionin e praktikës profesionale për çdo student dhe propozon përbërjen e Komisionit të vlerësimit të praktikave. Pedagogu mbikqyrës i caktuar për praktikën në vitin akademik 2018-2019 është mjek i specializuar me gradën Dr. shk. dhe me përvojë të gjatë spitalore, ndersa pedagogu mbikqyrës për praktika në vitin 2019-2020 është gjithashtu Dr. shk. Departamenti ka plotësuar edhe formularin <i>B.I.6 / Tabela përmbledhese e praktikës profesionale</i> ku u dokumentuan të dhënat për Institucionet si spitale, qendra shëndetësore në rrethe etj, si edhe personat e kontaktit që mbikqyrën nga afër studentët e Infermierisë në vendin ku ata kryen praktikën profesionale.¹⁰⁰</p> <p>Lidhur me temën e diplomës, në momentin që studentët duhet të plotësojnë formularin e temës së diplomës, paraprakisht, publikohet lista me anëtarët e departamentit dhe ekspertiza e tyre. Pasi studentët plotësojnë formularin, bëhet dhe shpërndarja e ngarkesës së studentëve në udhëheqja. Kërkesat miratohen në mbledhjen e departamentit, nga përgjegjësi i departamentit duke pasur në konsideratë përputhjen ndërmjet temës së studentëve dhe ekspertizës së pedagogut, si dhe numrin që mund të udhëheqë çdo pedagog.</p>

⁹⁸ Silabuset e lendeve (Ref. Nr. 19)

⁹⁹ Strategjia e Kërkimit shkencor 2017-2020; 2021-2025, pika 7 (Ref. Nr. 3.1; 3.2)

¹⁰⁰ ANEKS: Tabelat përmbledhese – Tabela 5 (Ref. Nr. 0.2)

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka marrëveshje me struktura spitalore për realizimin e orëve laboratorike. Është garantuar angazhimi i personelit ndihmës për realizimin e orëve laboratorike. ¹⁰¹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve. Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti) ¹⁰² . Institucioni programon politika dhe ndërmer masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik. ¹⁰³ (Reference Statuti UET, neni 30, pika 30.4)
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	UET synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit (sipas Statutit të UET studentët përfaqësohen me anëtarë në Senatin Akademik, Këshill i Etikës, KSBC) ¹⁰⁴ si dhe sigurimin e përfshirjes së studentëve më të dalluar të departamenteve apo fakulteteve përkatëse në kërkimin shkencor, botimet akademike, revistat shkencore, konferencat dhe workshopet, aktivitetin kërkimor-shkencor, etj. Gjithashtu, prej disa vitesh, Bordi i Tregut të Punës që ngrihet pranë departamentit është krijuar me anëtarë nga radhët e UET Alumni, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale pranë institucioneve ku janë punësuar. Një herë në muaj, Departamenti zhvillon mbledhje të hapur për studentët e programeve të tij, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit e më gjerë. Një politikë e tillë është ndjekur në mënyrë

¹⁰¹ Marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 34.1 – 34.7)

¹⁰² Bordi i Tregut të Punës (Ref. Nr. 12.1)

¹⁰³ Statuti UET, neni 30 pika 30.4 (Ref. Nr. 2)

¹⁰⁴ Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC; Të dhëna për anëtarët e KSBC (Ref. Nr. 30.4; 30)

	të vazhdueshme nga UET dhe vazhdon të jetë prioritet i ë Planit Strategjik 2016-2021. ¹⁰⁵ Ky kriter plotësohet diskutime të tilla zhvillohen gjatë mbledhjeve të hapura dhe nëpërmjet fokus grupeve të organizuara.			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Zyra e Këshillimit të Karrieres mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2009 kur u diplomuan studentët e parë, në UET është ngritur edhe shoqata Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në Europë e më gjerë. Sikurse u përmend edhe më sipër, UET angazhohet maksimalisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve ALUMNI që funksionojnë pranë UET, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë ALUMNI-t në strukturat konsultuese e drejtuese të universitetit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete/projekte zhvilluese të UET. Një politikë e tillë është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga UET dhe vazhdon të jetë në qendër të Planit Strategjik 2016-2021, pjesa Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore, pika 3.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Në rastet kur lind nevoja për organizimin e programeve të posaçme të cilat kanë fokus zhvillimin dhe përmirësimin e institucioneve, UET është gjithmone i hapur për të përbushur këto nevoja duke përshtatur dhe riorganizuar programet gjithmonë konform respektimit dhe zbatimit të ligjit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Institucioni UET ka objektiva të përcaktuara qartë për të përket kërkimit shkencor, duke orientuar dhe nxjerr vazhdimisht studentet e tij në këto drejtim. Kështu, edhe në programin e studimit përcaktohen qartë prioritetet dhe objektivat e studimit, parashikohen detyra dhe punime shkencore, në mënyrë që të aftësohen me të drejtë këto objektiva. Në të përcaktohen qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor, në pikën 3.3 të Rregullores mësimore. ¹⁰⁶ Referuar edhe pikës 3.1.5 pjesë e veprimtarive mësimore në fushën përkatëse është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të

¹⁰⁵ Plani Strategjik 2015-2020; 2021-2025, pjesa Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore, pika 1. (Ref. Nr.3; 3.3)

¹⁰⁶ Rregullorja e programit të studimit, pika 3.3 (Ref. Nr. 7)

	lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. UET cdo të martë organizon Forumet UET. ¹⁰⁷ Të ftuar në këto forume, janë personalitete të fushave të ndryshme, të cilët vijnë dhe bashkëbisedojnë me pedagogë dhe studentë. Në varësi të ekspertizës së të ftuarve, ftohen edhe pedagogët e departamenteve/fakulteteve për të marrë pjesë në to. Fakulteti dhe Departamenti nxit anëtarët e saj të marrin pjesë në Konferencën e Ditëve të Studimeve Shqiptare ¹⁰⁸ , ku çdo departament ka panelin e tij. Personeli akademik në UET ka liri akademike dhe gjithashtu behet pjese e aktiviteteve artistike, puneve kërkimore etj, duke respektuar gjithnjë mesimdhënien me korrekte maksimale në zbatim të objektivave dhe kurrikulave perkatese.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit nxit dhe motivon studentët të përfshihen në studime dhe projekte apo aktivitete kërkimore. Kjo realizohet nëpërmjet disa mënyrave. Së pari, disa pedagogë mund të nxisin që detyrën e kursit, ta realizojnë në terren duke kryer një mistudim, në bazë të kritereve të kërkimit shkencor. Një mënyrë tjetër, është përfshirja e studentëve në projektet kërkimore të pedagogëve të programit të studimit. UET cdo vit, realizon Konferencën Ndërkombëtare “Ditët e studimit Shqiptar” dhe nxit studentët të marrin pjesë si dëgjues apo të prezantojnë punimet e tyre. Studentet e universitetit vazhdimisht nxiten e motivohen për të marrë pjesë në studime, projekte e aktivitete kërkimore. Keto kryhen edhe nën mbikqyrjen e pedagogëve udhëheqës, të cilët kanë tituj e grada shkencore dhe janë të specializuar në ndjekjen e këtyre studimeve.
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Siç përcaktohet edhe në pikën 3 “Objektivat Strategjike” të Strategjisë së Kërkimit Shkencor, nëpërmjet kërkimit shkencor UET synon: <ul style="list-style-type: none"> • Të arrijë dhe të konsolidojë një pozicion dinjitoz, në mësimdhënie dhe në shkencë, si një nga universitetet më të mira të Shqipërisë dhe rajonit; • Të ndihmojë në progresin e dijes njerëzore, në krijimtarinë dhe praktikën profesionale, me qëllim që të krijojë impakt mbi shoqërinë dhe ekonominë nëpërmjet transferimit të dijes përtej komunitetit akademik, tek institucionet publike e private dhe grupet e interesit; • Të perfeksionojë mësimdhënien dhe zhvillimin akademik në të gjitha nivelet, në mënyrë që studentët të përjetojnë një përvojë dhe një kulturë akademike sfiduese; • Të realizojë një mjedis stimulues të kërkimit shkencor për stafin akademik dhe studentët nëpërmjet;

¹⁰⁷ Kalendar i Aktiviteteve (Ref. Nr. 55.1)

¹⁰⁸ DSSH (Ref. Nr. 55)

	<ul style="list-style-type: none"> • Si dhe te projektoje reputacionin e vet si nje <i>qender ekspertize</i> ne rrafshin kombetar 			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	UET është një institucion pionier në Shqipëri për sasinë dhe mënyrën e financimit të kërkimit duke dedikuar një sasi monetare çdo vit. Akademikët në UET janë të inkurajuar që të hulumtojnë dhe të publikojnë dhe në bazë të performancës marrin grantet e tyre kërkimore. Lidhja e shpërblimit financiar me arritje të matshme akademike është një mekanizëm i përshtatshëm për të kontrolluar dhe inkurajuar veprimtarinë shkencore dhe botimet. Në këtë mënyrë universiteti shmang shpërdorimin e burimeve, shpërblen ata që janë më aktivë dhe produktivë në kërkim, dhe krijon një mjedis ku kërkimi është pjesë integrale e jetës universitare. Te gjitha njesite baze jane te mbeshtetura financiarisht nga institucioni i cili ofron fonde per aktivitetet studimore, kerkimore dhe shkencore. Te ardhurat qe vijne prej aktiviteteve te ndryshme administrohen nga institucioni dhe pasqyrohen ne menyre transparente ne bilancet e vitit, duke u bere te aksesueshme nga fakultetet perkatese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8 Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Drejtimi I kërkimit shkencor, realizohet nga njesitë kryesore (Fakultet dhe Departamentet). Projektet e mëdha kërkimore, inkurajojnë interdisiplinaritetin dhe mundësojnë koordinimin shkencor. Grupet kërkimore të PMK-ve, kanë si qëllim materializimin e PMK-ve dhe realizimin e stuideve empirike, duke përmbushur objektivat e PMK-së dhe janë në koherencë me akset kërkimore individuale të kërkuesve shkencor të përfshirë në to. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka marrëveshje me struktura spitalore universitare për realizimin e puneve kerkimore shkencore, duke vene ne dispozicion te dhena prej arkivave, kartelave e pavioneve. Është garantuar angazhimi i personelit ndihmës për realizimin e bashkpunimeve me struktura te ndryshme kerkimore. Gjithashtu ka nisur puna për ndërtimin e ambienteve specifike te pajisura me teknologji te mirefillte per te kryer eksperimente e kerkime shkencore brenda kampusit UET.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin	Është garantuar angazhimi i njesise pergjegjese për pergjigje ndaj kërkesave per studime e projekte kerkimore shkencore, gje per te cilen eshte perfshire edhe personeli akademik si dhe studentet.

<p>akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Grupet drejtuese të PMK-ve janë një mekanizëm i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm të cilësisë së produktit shkencor pasi, ndër të tjera, vendosin për punimet që pranohen në DSSH dhe orientojnë kërkimin shkencor të Junior Researchers që punojnë në PMK-të përkatëse. Grupet kërkimore shërbejnë gjithashtu edhe si ‘strehë’ për doktorantët të cilët atashohen pranë një grupi kërkimor dhe zhvillojnë pranë tyre punimin doktoral. Grupet kërkimore, duke qenë se janë në linjë me PMK-të dhe strehojnë doktorantët. Ky organizim kapilar inkurajon kërkimin, mundëson ndërdisiplinaritetin si dhe orienton kërkuesit drejt atyre çështjeve të cilat kanë rëndësi për UET dhe partnerët jashtë UET.</p>			
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare, organizohet çdo vit në muajin prill. Panelet organizohen mbi bazën e fakulteteve dhe Projekteve të Mëdha Kërkimore. Kjo konferencë ndihmon personelin Akademik dhe studentët për arritjen e objektivave kërkimore shkencore. Cdo muaj organizohen prej fakultetit konferenca, aktivitete, biseda të hapura midis studenteve dhe personelit në mënyrë që të plotësohen objektivat e vendosura në fushën e programit të studimit. Të gjitha këto mbledhen dhe afishohen në listën e aktiviteteve të cilat mund të aksesohen në çdo moment tek koordinatorja e programit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies UET ka hartuar udhëzues të hollësishëm sa i takon parimeve të hartimit të silabuseve, metodave të mësimdhënies, përzgjedhjes së literaturës, sistemit të kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të studentëve, këshillimit akademik dhe tutoriatit. Gjithashtu UET organizon vazhdimisht trajnime të personelit akademik të fokusuar kryesisht në</p>

	<p>aspektet didaktike të mësimdhënies, duke nxitur përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit. Gjithashtu trajnime zhvillohen edhe në kuadër të angazhimit në veprimtari kërkimore shkencore dhe të publikimeve në revista shkencore serioze. UET ka të përcaktuar qartë në rregulloren e programit të studimit neni 3 dhe në çdo silabus se cilat janë metodat e vlerësimit sipas kategorizimit të lëndëve, fushës së studimit. Këto dy dokumentacione së bashku me dokumentat kryesore të UET bashkangjitur këtij raporti përbëjnë udhëzuesin kryesor për mësimdhënësit.¹⁰⁹</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Qe prej fillimit të hapjes së programeve, komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UET në bashkëpunim me Zëvendës Rektoren për Procesin Mësimor dhe me Dekanët dhe Drejtuesit e Departamentit dhe Sekretarinë e Përgjithshme është përgjegjës për monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrativ.</p> <p>Gjatë vitit akademik ky komision në mënyrë specifike realizon një vlerësim në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe gjejnë reflektimin e tyre në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.¹¹⁰</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni gjatë vlerësimit të tij me anë të sondazheve të studentëve përfshin edhe pyetje në lidhje me format e mësimdhënies, mënyrës së vlerësimit të dijeve, mundësinë e ankimit etj. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e performancës së anëtarëve të personelit akademik, jo vetëm në kuadër të cilësisë së mësimdhënies, por edhe të aspekteve të sjelljes, komunikimit, mbështetjes së studentëve, cilësisë së literaturës së përzgjedhur, etj., është një nga komponentët më të rëndësishëm për të evidentuar dhe adresuar problemet e mundshme.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UET në bashkëpunim me departamentin dhe dekanin dhe Drejtorin e IT bëjnë publike për të gjithë stafin akademik në formë të personalizuar vlerësimin e dhënë nga studentët. Ky vlerësim tregon në përqindje vlerësimin për secilën pyetje të bërë.</p> <p>Dokumentacioni ku bëhet vlerësimi i stafit akademik është lehtësisht i aksesueshëm nga student <i>Kodi: G.III.4.2/Formular Vlerësimi i Studentëve Për Pedagogun dhe Lëndën.</i></p> <p>Komisioni, si rregull, kryesohet nga Rektori dhe ka në përbërje Prorektorin, Dekanin e Fakultetit, Përgjegjës të Departamentit, Drejtuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, si edhe ekspertë të jashtëm nëse shihet e arsyeshme. Administratori i UET ka të drejtën të marrë pjesë në punimet e Komisionit.</p> <p>Komisioni interviston në mënyrë individuale secilin pedagog të brendshëm dhe të jashtëm të UET-it në lidhje me kryerjen nga</p>

¹⁰⁹ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 3 (Ref. Nr. 7)

¹¹⁰ Rregullore e UET, Neni 22 (Ref. Nr. 5)

	<p>pedagogu të të gjitha detyrimeve kontraktuale me cilësinë dhe sasinë e duhur.</p> <p>Gjithashtu, në vlerësim kalojnë edhe pedagogët e jashtëm që udhëheqin diploma ose disertacione në UET.</p> <p>Në përfundim të procesit të vlerësimit Komisioni harton Raportin e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik, një kopje e të cilit depozitohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe tek Administratori.</p> <p>Raporti i i Vlerësimit të Performancës së personelit akademik përdoret si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit ndërmjet UET-it dhe personelit akademik të brendshëm e të jashtëm të tij, si në drejtim të kohëzgjatjes së marrëdhënies së punësimit, ashtu edhe të shpërblimit.¹¹¹</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në filozofinë e UET-it, kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik është në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore, që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive dhe zbatimin e metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve.</p> <p>Promovimi i shembujve dhe praktikave të mira synohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UET me fillimin e vitit akademik, dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e institucionit, pedagogët, etj.</p> <p>Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të KSBC-së dhe reflektohet në format dhe formatet standarde të publikuara në intranetin e UET.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p> <p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies në progamin e studimit MSH në Infermieri janë : leksionet, seminarët, detyrat e kursit, orët e hapura këto të fundit të organizuara nga departamenti.¹¹²</p> <p>Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe ti plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit.</p> <p>Të gjitha këto forma të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të detajuara në pikat 3 Struktura e Programit të Studimit dhe 5.6 të Rregullores së Programit të Studimit bashkangjitur në dhe</p>

¹¹¹ Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40); Formular Vlerësimin e Pedagogut (Ref. Nr. 40)

¹¹² Rregullore e programit të studimit MSH Infermieri

	<i>Rregullores së Universitetit Europian të Tiranës (Neni 17 Planifikimi i procesit mësimor).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për të gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike. UET ka të parashikuar në rregulloren e tij edhe rastet e studentëve me nevoja të veçanta ¹¹³ , duke marrë në konsideratë diversitetin midis studentëve. Të gjitha rastet e vecanta parashikohen në pikën 27.3 <i>Provimet, Rregullorja e Universitetit Europian të Tiranës</i> , ku prezantohen mënyra dhe metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies që nga format direkte të përgëndruara e deri tek ato online.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.	Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET lidhet me trajnimin e pedagogëve. Institucioni siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. Universiteti organizon në mënyrë periodike Staff Development Day – Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. Gjithashtu në fillim të vitit akademik, Universiteti organizon edhe trajnimin dyditor “Back to work”. Gjithashtu, personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikën e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. ¹¹⁴
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Universiteti Europian i Tiranës falë kredibilitetit që ka në publik, rezultateve pozitive në akreditime kombëtare dhe ndërkombëtare, politikave konkurruese në trajtimin financiar të stafit akademik ka arritur të ketë stafin më të përgatitur dhe më kompetent të përshtatshëm për profilet që ofron ky program studimi. Pedagogët e angazhuar në programin MSH Infermieri, përveç titujve dhe gradave kanë edhe ekspertizë profesionale në lëndët ku janë titullarë. Personeli akademik gjatë leksioneve/seminareve përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, ku në varësi të tematikës përdor metodat tradicionale ose bashkëkohore të mësimdhënies. Këto metoda ndërthuren duke pasur herë në qendër studentin dhe herë pedagogun si dhe konkretizohen me mjete audiovizuale. ¹¹⁵
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Personeli akademik në UET prezantohet cdo semester dhe vit me rezultatet që kanë dalë nga sondazhet, dhe ftohet që të përmirësojë në mënyrë periodike duke u bazuar edhe në këto rezultate format dhe metodat e mësimdhënies. Ky proces ndiqet intesivisht edhe nga KSBC-ja e cila nëpërmjet ekspertëve të saj vlerëson sylabuset, literaturën, provimet dhe jep rekomandimet e nevojshme për përmirësim. Edhe gjatë ditëve të

¹¹³ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 27.3 (Ref. Nr. 5)

¹¹⁴ Të dhëna për shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43)

¹¹⁵ Syllabuset e lendeve (Ref. Nr. 19)

	<p>vlerësimit të kolegut ose eprorit (sipas përcaktimeve në formularin e vlerësimit bashkangjitur këtij raporti) personeli akademik ftohet të bëjë përmirësimet (në rast se evidentohet) në format dhe metodat e mësimdhënies.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes:</p> <p>a. vlerësimit të Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit dhe/ose përgjegjësit të grup-lëndës përkatës;</p> <p>b. vlerësimit të studentëve që kryhet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatën e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit;</p> <p>c. vetëvlerësimit;</p> <p>d. rezultateve të raporteve të KSBC-së;</p> <p>e. vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (follow-up).</p> <p>f. leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara.</p> <p>Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese.¹¹⁶</p> <p><i>(Neni 22 Vlerësimi i procesit mësimor në Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës).</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit në Master Shkencor në Infermieri është mjaft i motivuar për të përdorur forma interaktive dhe diskutimi për të rritur interesin e studentëve, shembull për këtë janë orët e leksionit ku personeli akademik fton ekspertë të fushës për të dhënë një dimension më real lëndës, si dhe paraqet materiale të ndryshme audiovizive në lidhje me temën apo çështjen që trajtohet atë orë leksioni.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Format e mësimdhënies në programin e studimit MSH në Infermieri janë interaktive po njëherazi nxisin studentët të mendojnë në mënyrë aktive duke i inkurajuar ata të punojnë në grupe gjatë orëve të seminarit ku secili prej tyre ka një përgjegjësi për të përgatitur apo referuar një material.</p> <p>Programi i studimit MSH në Infermieri është një program sa teorik po aq edhe i lidhur me studime praktike në shoqëri, edhe lëndët dhe modulet nga të cilat ky program përbëhet, i nxisin studentët që të punojnë në mënyrë individuale në vendet e tyre të punës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

¹¹⁶ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 22 (Ref. Nr. 5)

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Infrastruktura e UET që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor dhe atij shkencor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë të ri-konstruara dhe mobiluara së fundmi, me sistem kondicionimi dhe sistem wireless. Gjithashtu edhe biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqip dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në zyra individuale ose dyshe. Përgjegjësit e departamenteve, dekanët, zv. Rektorët dhe drejtuesit e tjerë janë akomoduar në zyra individuale. Në dispozicion të departamenteve janë sallat e mbledhjeve. Mirëmbajtja dhe pastrimi i ambienteve realizohet nga punonjësit e shërbimit dhe nga firma e kontraktuar për këtë qëllim.¹¹⁷</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET ka investuar në sisteme të cilat mbështesin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS). Ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e ngarkuara nga pedagogu, si leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Në ambientet e dizenuara për laborator funksionojnë më së miri të gjitha sistemet informatike dhe ka një departament mbështetës të gatshëm në çdo moment për ti ardhur në ndihmë studentëve dhe pedagogëve në raste avarie.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Në UET literatura bazë në programin e studimit MSH në Infermieri është në dispozicion të studentëve, ajo gjendet gjithmonë në librarinë dhe bibliotekën e UET. Në rastet kur literatura mungon ajo është e siguruar gjithmonë në formë elektronike për studentët edhe në format pdf-je.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e UET është tepër e pasur dhe ka një numër të madh librash të botimeve të fundit të cilat i përkasin drejtimeve kryesore të programeve të studimit. Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutera dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti Wireless. Biblioteka ka krijuar një Katalog me libra elektronik në gjuhë të huaj, i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit.</p>

¹¹⁷ Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit (Ref. Nr. 42)

<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC dhe mundëson aksesin në libraritë online si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët. Staf i bibliotekës ofron mbështetje për gjetjen e burimeve të kërkuara online. Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: EBCSO, Emerald, Cambridge University, Taylor & Francis, Questia, etj.</p>			
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 3 laboratorë mësimorë Informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC, video projektor. Lab 206 B me 35 PC, video projektor. Lab 207 B me 35 PC, video projektor. Lab 208 B me 80 pc (Laboratori i internetit). 33 salla mësimore (leksione dhe seminare) janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me pc në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin. Laboratorët e informatikë/statistikës janë pajisur me software-et e nevojshëm për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Si pedagogët ashtu edhe studentët përdorin platformën LMS (Learning Management System). Leksionet, materialet shitesë, leximet, detyrat, vlerësimet dhe përgjithësisht gjithë komunikimi zhvillohet përmes LMS. Si pedagogët ashtu edhe studentët e përdorin rregullisht këtë platformë.¹¹⁸</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik shfrytëzon sistemin LMS (Learning Management System) për të komunikuar me studentët për leksionet, udhëzimet dhe transferimin e vlerësimeve.¹¹⁹ Personeli akademik në UET ka ndërkohë akses në dokumentacionin elektronik siç janë dokumentacionet kryesore të UET (statut, rregullore, kod etike, procedura, formularë vlerësimi, model tezash vlerësimi etj).</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Përpara se studenti të bëjë aplikimin për temë diplome, Departamenti i vë në dispozicion ekspertizën e anëtarëve të personelit akademik, me drejtimet ku ata mund të udhëheqin tema. I gjithë procesi nga aplikimi deri tek dorëzimi i punimit dhe mbrojtja e temës, është i rregulluar në mënyrë të detajuar me dokumentin B.II, pjesë e Broshurës së dokumenteve¹²⁰. Pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike për të asistuar dhe mbështetur studentët gjatë fazës së shkrimit të temës, sipas një kalendari takimesh, të shpallur.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4

¹¹⁸ ANEKS: Tabelat mbështetese – Tabela 17

¹¹⁹ ANEKS: Tabelat mbështetese – Tabela 17

¹²⁰ Dokumenti B. II Mbi punimin e diplomës (Ref. Nr. 10)

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë është Departamenti. <i>Struktura Organizative e Rregullore e Universitetit European të Tiranës</i> përcakton njësitë përbërëse të strukturës dhe se si ato janë të ndërlidhura me njëra tjetrën në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të koordinimit të aktiviteteve në funksion të cilësisë së mësimdhënies.¹²¹</p> <p>Një ndër njësitë kryesore që asiston në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshin stafin akademik është Zyra e Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim misioni i së cilës është të ndihmojë në rritjen e misionit akademik dhe kërkimor të UET-it. Gjithashtu Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime në rastet e përmirësimeve të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies është Departamenti¹²². Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me parimet dhe kriteret e vendosura për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Gjithashtu përgjegjësi i departamentit miraton silabuset e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimit nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar, në mbledhjet e hapura me ta, por jo vetëm. Stafi dhe studentët e dinë që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të mësimdhënies, gjë e cila rrit vetdijen për cilësinë e mësimdhënies.¹²³</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja inovative në procesin e mësimdhënies. Në formatin që përdoret për hartimin e silabuseve, personelit akademik i kërkohet të evidentojë në një seksion të vecantë listën e materialeve audio-vizuale që do të përdoren në mësimdhënie. Në UET strukturat përgjegjëse për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit, Broshura e Dokumenteve në Zbatim të Statutit dhe Rregullores Bazë të UET-it përcaktojnë kriteret mbi të cilat duhet të zhvillohet procesi mësimdhënës ku</p>

¹²¹ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Kreu 2, Neni 5 (Ref. Nr. 5)

¹²² Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Kreu 2, Neni 5 (Ref. Nr. 5)

¹²³ Dokumenti F.V. Për organizimin dhe funksionimin e departamentit pika F.V.2, F.V.3 F.V.4, F.V.5 (Ref. Nr. 6)

	metodat inovative inkurajohen. Shih pikën III.1.1 të këtij raporti.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UET-i është i angazhuar maksimalisht për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. Ai mbështet zhvillimin e konferencave shkencore nga njësitë bazë; pjesëmarrjen e pedagogëve në konferenca dhe aktivitete të rëndësishme shkencore jashtë vendit. Gjithashtu, UET mbështet kualifikimin e pedagogëve pa gradë për të ndjekur studimet e doktoraturës, si në UET, ashtu edhe në institucione jashtë vendit, duke akorduar periudha disa mujore pushim të paguar. Në sajë të aktivizimit të UET në programet e mobilitetit me programet Erasmus dhe programet e tjera të shkëmbimeve në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, dhjetra pedagogë kanë patur mundësinë të shkojnë për një periudhë mësimdhënieje apo trajnimi në universitet më të mira përëndimore. Shih Listën e Projekteve dhe bashkëpunimeve bashkangjitur. ¹²⁴
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Në UET departamenti dhe Fakulteti, në bashkëpunim me njësitë e tjera ndihmëse është shumë aktiv në trajnimin dhe organizimin e oreve të hapura me pedagogë dhe studentë me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Aktivitetet për trajnimin dhe prezantimin e metodave të reja në mësimdhënie dhe dokumentacioni i UET i përmendur edhe më lart ndihmojnë personelin akademik dhe ndihmës të angazhohen për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik ka lirinë të testojë metoda të reja në mësimdhënie, dhe duke qenë se silabuset e lëndëve rishikohen çdo vit, ka mundësi të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët. Nëse gjatë punës së tyre ata vënë re se një eksperiencë e re është efektive, raportojnë për rezultatet në mbledhjen e departamentit, me synim që kjo eksperiencë pozitive të përhapet dhe shfrytëzohet edhe nga kolegët e tjerë. Por dhe në trajnimet e ndryshme të personelit akademik, stafi është i lirë të sugjerojë metoda që kanë rezultuar pozitive dhe të diskutojnë rreth tyre, me qëllim përhapjen e praktikave më të mira.
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Angazhimi i lektorëve të ftuar, të cilët janë profesionistë të fushës, shihet si element shumë i rëndësishëm për pasurimin e procesit të mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës. Kjo është sidomos e vlefshme në rastin e programeve Master Shkencor. Shembujt infermierorë të ekspertëve me përvojë pune në praktikën klinike bëjnë që tema të bëhet më e prekshme për studentët dhe të përvetësohet më lehtë. Kjo bën që edhe rezultatet e të nxënit të jenë më të larta. Gjithashtu UET zhvillon vazhdimisht seminare dhe trajnime me qëllim që

¹²⁴ Të dhëna për shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43)

	anëtarët e personelit jo vetëm të zhvillohen më tej, por edhe të mund të shkëmbejnë përvojën e tyre me kolegët. Disa nga aktivitetet e zhvilluara kanë qenë: “How to publish and research (29.06.2017); Si të jemi lektorë të sukseshëm (29.01.2016).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<i>Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës në Kreun V Kontrolli dhe Vlerësimi i Dijes</i> përcakton qartë Sistemin e Vlerësimit (Neni 23), Mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve (Neni 24), Frekuentimi i procesit mësimor (Neni 25), Detyra praktike dhe detyra e kursit (Neni 26), Provimet (Neni 27), Riprovimet dhe bartja (Neni 28), Kalimi në vitin pasardhës (Neni 29), Përmirësimet (Neni 30), Numri i provimeve për të njëjtën lëndë brenda të njëjtit sezon (Neni 31), Kërkesa për rivlerësim (Neni 32), Plagjiatura dhe kopjimi (Neni 33). ¹²⁵ Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Gjithashtu studenti mund të përfitojë nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm që ofrohet nga Koordinatorja e departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Informacion i detajuar përsa i përket metodologjisë së testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve e aftësive profesionale shkencore gjendet në syllabusin e lëndës i cili prezantohet tek studentët gjatë orës së parë të leksionit dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion në platformën LMS.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i dijeve dhe aftësive personale ndryshon sipas tipologjisë së lëndës. Një informacion i detajuar për mënyrën dhe formën e vlerësimit gjendet në Rregulloren e programit të studimit, neni 5 verifikimi i dijeve të fituara nga studentët dhe syllabusin e çdo lënde. ¹²⁶			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹²⁵ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Kreu 5, Neni 23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33 (Ref. Nr. 5)

¹²⁶ Rregullorja e programit të studimit, Neni 5 (Ref. Nr. 7)

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Dokumenti Broshura e Dokumenteve specifikon: A.IV.1. Kontrolli i vazhdueshëm i dijeve.</p> <p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë.</p> <p>a. Nxiti studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit;</p> <p>b. Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim;</p> <p>c. Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs.</p> <p>Vlerësimi i studentëve ka natyrë stimuluese dhe jo penalizuese. Ai synon të tregojë se çfarë di studenti dhe çfarë duhet të mësojë më shumë. Për këtë qëllim çdo vlerësim i pedagogut duhet të shoqërohet me koment të përkatës.</p> <p>Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>UET përdor programin turnitin/ephorous që prej 16 tetor 2015 për të evituar plagjaturën e eseve dhe temave të diplomës.</p>
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Sipas <i>Broshurës së Dokumenteve</i>, pika A.IV.2.6. <i>Hyrja në provim</i>, parashikon se:</p> <p>a. Studentët duhet të paraqiten në provim me një dokument identifikimi. Ata futen në sallën e provimit nga pedagogu i lëndës dhe/ose pedagogët e caktuar për të siguruar mbarëvajtjen e provimit, dhe vendosen nëpër banka sipas rendit alfabetik që kanë në regjistër;</p> <p>b. Studentët duhet të lënë në një vend të veçantë (në bankat e para) çantat, librat, leksionet dhe çdo material tjetër mësimor e informativ që ka lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me lëndën e provimit. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi. Mosrespektimi i këtij rregulli nga ana e studentit duke e mbajtur aparatin e telefonit celular në gjendje pune konsiderohet shkelje e rregullores dhe penalizohet me përfundimin e provimit për studentin në fjalë dhe vlerësimin e tij me notën 4;</p> <p>c. Studenti nuk mund të hyjë në sallën e provimit duke pasur me vete armë, edhe në rastin kur e zotëron atë për shkak të detyrës që kryen.</p> <p>d. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar nga Departamenti, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë.¹²⁷ Cdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit.</p>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë	<p>Sipas <i>Broshurës së Dokumenteve</i>, pika A.IV.2.6. <i>Hyrja në provim</i>, parashikon se:</p>

¹²⁷ Dokumenti A.IV. sistemi i vlerësimit të studentëve, pika 2.6 (Ref. Nr. 7.1)

<p>anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Studentët pajisen me një barkod të vecantë për secilin prej tyre, barkod i gjeneruar nga Sekretariteti Mësimor, të cilat i vendosin në dispozicion pak para hyrjes në provim tek Koordinatorja e Fakultetit. Më pas koordinatorja e ndihmuar edhe nga sekretaret apo personel shtesë, vendos në secilin provim studentit, korresponduar me kartën e identitetit përkatëse të studentit, barkodin e tij.</p> <p>Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, e cila ruan anonimatën e studentit deri në korigjimin e tezave nga pedagogu i lëndës.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sikurse theksohet edhe në dokumentin Broshura e Dokumenteve e Universitetit Europian të Tiranës (Neni 27 Provimet):</p> <p>Vlerësimi i studentit me pikë duhet të jetë i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve.</p> <p>Po kështu në Broshurën e Dokumenteve, në seksionin A.V. 2.1 Detyrat e pedagogut, specifikohet se pedagogu:</p> <p>d. Jep udhëzimet përkatëse lidhur me zhvillimin e provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar;</p> <p>e. Sqaron dhe argumenton vlerësimin e marrë nga studentit për çdo detyrim të lëndës.</p> <p>Në të njëjtin dokument në seksionin A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve përcaktohet se:</p> <p>A.IV.1.2. Vlerësimi i studentëve ka natyrë stimuluese dhe jo penalizuese. Ai synon të tregojë se çfarë di studentit dhe çfarë duhet të mësojë më shumë. Për këtë qëllim çdo vlerësim i pedagogut duhet të shoqërohet me komentën përkatës.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Sipas <i>Nenit 33 Plagjiatura dhe Kopjimi</i> në dokumentin <i>Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës</i>:</p> <p>33.1 Plagjiatura nënkupton paraqitjen pa citim të materialeve të shkruara, të marra në përmasa të konsiderueshme nga një autor tjetër si tekste personale, në formë të pandryshuar dhe/ose në formë të përshtatur. Plagjiatura e provuar në paraqitjen e esesë dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare në disiplinën ose veprimtarinë formuese përkatëse, pavarësisht vlerës së elementëve të tjerë vlerësues.</p> <p>Kopjimi nga materiale të shkruara ose nga fleta e provimit të studentëve të tjerë si edhe çdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit për studentin që shkel rregullin, dhe studentit vlerësohet me notën 4 (katër) në lëndën në fjalë. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi.</p> <p>Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studentit paralajmërohet për përjashtim nga Universiteti. Herën e tretë të përsëritjes së kopjimit ose të plagjiaturës studentit përjashtohet</p>

	nga Universiteti dhe humbet çdo të drejtë financiare që mund t'i takojë në bazë të kontratës së lidhur me UET-in. ¹²⁸			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Provimet janë të sekretuara, pra kriteri i vetëm i vlerësimit të tyre është performanca e studentit në provim. Sikurse theksohet edhe në dokumentin <i>Rregullore e Universitetit European të Tiranës (Neni 27 Provimet)</i>:</p> <p>Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi, e cila ruan anonimatin e studentit deri në korigjimin e tezave nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Vlerësimi i studentit me pikë duhet të jetë i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve.</p> <p>Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese.¹²⁹ Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë.</p>			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Procedura e ndjekur është transparente për palët e përfshira dhe dokumentohet dhe arkivohet. Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit përmes sistemit online. Ai informohet nga koordinatorja e departamentit për orarin që pedagogu ka vendosur për zhvillimin e seancës sqaruese. Gjatë kësaj seance, pedagogu i jep mundësi çdo studentit të rishikojë tezën dhe e informon në lidhje me përgjigjet e pyetjeve dhe elementët ku ai ka gabuar.</p> <p>Për format e ankimimit shih Formatin: <i>KODI: A.IV.4/KËRKESË PËR RIVLERËSIM</i>, vihet në dispozicion të studentit për të bërë kërkesën për rivlerësim¹³⁰.</p>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Pas seancave sqaruese, nëse studentit i mbetet i bindur se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, atëherë mund t'i drejtohet Departamentit me kërkesë për rivlerësim. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar¹³¹. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

¹²⁸ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 33, pika 33.1 (Ref. Nr. 5)

¹²⁹ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 27 (Ref. Nr. 5)

¹³⁰ Dokumenti A.IV.4 Kërkesë për rivlerësim (Ref. Nr. 7.1)

¹³¹ Rregullorja e programit të studimit, pika 5.8 (Ref. Nr. 7)

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit MSH në Infermieri ka si qëllim garantimin e thellimit të njohurive mjekësore në specialitete të ndryshme të mjekësisë, duke e aftësuar studentin profesionist të së ardhmes jo vetëm teorikisht, por duke e pajisur atë edhe me aftësi profesionale praktike sipas punës që do të nevojitet të kryejë në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në përfundim të këtij programi studimi, studenti duhet të zotërojë njohuritë dhe kompetencat :</p> <p>a.marrë pjesë në identifikimin e nevojave shëndetësore të individit dhe të komunitetit;</p> <p>b.identifikojë nevojat e kujdesit infermieror të individit dhe të komunitetit dhe formulojë objektiva relative;</p> <p>c.planifikojë, drejtojë dhe vlerësojë ndërhyrjen e ndihmës së infermierit;</p> <p>d.garantojë aplikimin korrekt të recetave diagnostiko-terapeutike;</p> <p>e.veprojë si individualisht ashtu edhe në bashkëpunim me të tjerë operatorë shëndetësorë e socialë, duke përfituar, aty ku duhet, nga puna e personelit mbështetës;</p> <p>f.ndihmojë në krijimin e personelit mbështetës dhe bashkëpunojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kërkimet shkencore;</p> <p>g.jetë i aftë të ofrojë në bashkëpunim me profesionistët e tjerë mjekësorë shërbim parandalues, diagnostikues dhe trajtues adekuat;</p> <p>h.jetë i aftë të vlerësojë gjendjen nutricionale të individëve të shëndoshë dhe pacientëve.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Si rregull, pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre në lidhje me gjërat që mund të përmirësohen në vijim. Eseja apo detyra e kursit që zhvillohet përpara përfundimit të lëndës është një formë e shqyrtimit të aftësisë së studentëve për të kuptuar çfarë ata kanë përfituar nga lënda.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në orën e fundit të mësimi, pedagogu përveçse ndalet edhe njëherë në çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, jep edhe orientimet e nevojshme se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementët që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët, gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet, gjatë orëve të hapura me të ftuar special dhe institucione të cilat paraqesin zhvillimet më të reja në fushën e teknologjisë dhe mjekësisë.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Qëllimi i studimeve të Masterit Shkencor në Infermieri, akoma edhe më tepër se cikli i parë i studimit, është edhe aplikimi në praktikë i njohurive teorike të marra. Për këtë arsye një vëmendje e veçantë dhe kohë specifike e mjaftueshme i kushtohet edhe dërgimit të studentëve në qendra spitalore dhe ndjekjes së tyre nga pedagogë dhe profesionistë përkatës për të mësuar dhe ushtruar nga afër cdo gjë që parashikohet në praktikë. Në <i>Broshurën e Dokumenteve</i>, dhe në syllabuse bashkangjitur janë të detajuara edhe format e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet në veçanti në këtë program studimi, ku puna në grup zë një vend të veçantë. Ky kriter është theksuar edhe në syllabus dhe format e vlerësimit të lëndëve bashkangjitur. Studentët e UET realizojnë në javën e 13 të secilës lëndë një detyrë kursi në grup, ku secili student shpalos idetë e tij për realizimin e një objekti të caktuar mësimor.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Po ky kriter plotësohet, dhe ka rezultuar edhe gjatë monitorimit të orëve të mësimit dhe nga fokus grupet. Personeli akademik është i informuar për strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe strategjinë kërkimore shkencore përmes një dokumentacioni të gjerë rregullator që është i publikuar në intranet, në një folder ku i gjithë personeli ka akses. Gjithashtu personeli akademik kërkohet të inkurajojë edhe përfshirjen e studentëve, sidomos atyre të ciklit të tretë dhe të ciklit të dytë Master i Shkencave, në punën kërkimore shkencore.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Po, ky kriter plotësohet, në veçanti me angazhimin që UET ka me programet Erasmus + për mobilitetin e studentëve dhe të stafëve akademike, bashkangjitur lista e projekteve dhe bashkëpunimeve.</p> <p>Për shkak se programi Master është një program i hapur rishtas ende nuk ka mobilitet të mbështetur nga Erasmus për këtë program.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Shkëmbimet e personelit akademik në universitetet partnere perëndimore, në kuadër të projekteve Erasmus + KA1, mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira, të cilat adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në UET, dhe mund të përhapen edhe tek kolegët e tjerë në institucion. Kështu diferencat që mund të ekzistojnë me universitetet jashtë ngushtohen dhe mobiliteti i studentëve dhe përshtatja e tyre me mjedisin e institucioneve pritëse bëhet me e lehtë, pasi ata</p>

	hasin praktika të ngjashme me çfarë kanë përjetuar gjatë studimeve në UET.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	UET ka të përcaktuar edhe në Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren e Programit të Studimit, rregullat e mbrojtjes së diplomës. ¹³²
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Po ky kriter plotësohet, detajuar në standartin III.6/4.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Të gjitha lëndët e programit kanë peshën e tyre specifike në provimin përfundimtar dhe secila prej tyre është e përfshirë në formë të vecantë ose të kombinuar në trajtën e një rasti klinik. Cdo mënyrë vlerësimi përcaktohet nga një komision specifik, i cili përmban pedagogë që janë në brendësi të njohurive të marra prej studentëve që kanë ndjekur programin në fjalë.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Pedagogu udhëheqës e orienton dhe ndihmon studentin jo vetëm në përcaktimin e temës së diplomës, por për cdo vështirësi me të cilën studenti ndeshet gjatë punës së tij. Udhëheqësi zhvillon seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	UET asiston gjatë gjithë kohës studentët me ekspertizë të ofruar nga pedagogët dhe stafi ndihmës për realizimin e matjeve, analizave dhe mbledhjes së të dhënave (siç është psh shpërndarja e pyetsorëve online, mbledhja e të dhënave etj). ¹³³
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	UET asiston gjatë gjithë kohës studentët me ekspertizë të ofruar nga pedagogët dhe stafi ndihmës për realizimin e nxjerrjes së rezultateve, përpunimin e tyre etj. UET nëpërmjet udhëzimeve të drejtëpërdrejta dhe ato institucionale të mbështetura me dokumentacion dhe formate të strukturuar ¹³⁴ jep udhëzime mbi strukturën e prezantimit të një teme diplome master.

¹³² Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, pika 5.3 (Ref. Nr. 7); Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Kreu 5, Neni 27 (Ref. Nr. 5)

¹³³ Dokumenti për punimin e diplomës, pika B.II.5.2 (Ref. Nr. 10)

¹³⁴ Dokumenti për punimin e diplomës, pika B.II.6.2 (Ref. Nr. 10)

Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni brenda 6 (gjashtë) muajsh me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm. Deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, UET-i lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave. ¹³⁵			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Po ky kriter plotësohet. Studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të sylabuseve të programit të studimit të zhvilluar. ¹³⁶			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e	Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore ¹³⁷ , e cila krijon Dosjen Individuale

¹³⁵ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 40 (Ref. Nr. 5)

¹³⁶ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 40, 41. (Ref. Nr. 5)

¹³⁷ Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.	të Stafit Akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme, në të cilat depozitohet i gjithë dokumentacioni ¹³⁸ . Zyra e Burimeve Njerëzore mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër.								
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	UET i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme ¹³⁹ .								
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik janë të parashikuar në dokumentin përkatës, në të cilin përcaktohen fazat nga evidentimi i nevojave për personel të ri e deri tek vlerësimi i performancës së personelit akademik. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për çdo vend vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit ¹⁴⁰ , rrjetet sociale ¹⁴¹ dhe në gazetën Liberale.								
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim. Këto procedura janë të përcaktuara në dokumentet e brendshme të institucionit ¹⁴² . Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Po, ky kriter plotësohet. Institucioni është i angazhuar në krijimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit të përshtatshëm për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Stafit akademik ka ambiente të bollshme për kryerjen e detyrave në procesin mësimdhënës dhe shkencor, zyrat e pedagogëve janë të mirëpajisura me kompjutera, sistem kondicionimi dhe ndricimi, dhe janë individuale ose të ndara me kolegë, ku secili ka postin e tij të punës. ¹⁴³
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin	Zhvillimi profesional i stafit është një ndër objektivat strategjik të institucionit, i cili garantohet si nga zhvillimi i aktiviteteve

¹³⁸ Format Dosje Stafi Akademik (Ref. Nr. 44.1 & 44.2)

¹³⁹ Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

¹⁴⁰ Faqja zyrtare e UET <http://uet.edu.al/new/thirrje-aktuale-per-punesim/>

¹⁴¹ Shembull thirrje për staf akademik (Ref. 11.1)

¹⁴² Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 22 (Ref. Nr. 5); Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

¹⁴³ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

<p>e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>nga vetë institucioni ashtu edhe nga mbështetja institucionale për stafin për të ndjekur trajnime dhe aktivitetet të tjera zhvillimore në institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit¹⁴⁴. Zhvillimi i konferencës shkencore ‘Ditët e Studimeve Shqiptare’ sikurse dhe botimi i revistave shkencore (Revista Medicus e specializuar në fushën e shkencave mjekësore) janë disa nga treguesit e rëndësishëm që institucioni i kushton zhvillimit të vazhdueshëm të stafit. Përfshirja në një numër të konsiderueshëm projektesh, të financuara nga donatorë të ndryshëm, dhe me partnerë nga vendet e BE-së dhe rajoni, është një tjetër tregues i strategjisë së institucionit në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të stafit.</p> <p>UET ka ndërtuar skemën e financimit të kërkimit shkencor, duke krijuar një fond prej 75.000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters. Nisma më e fundit e UET është krijimi i një Grupi Kërkimi Ndërdisciplinor prej 10 profesorësh të disiplinave të ndryshme, të cilëve iu është akorduar një fond vjetor për kërkim shkencor, prej 5.000 euro/secili.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në bashkëpunim me <i>Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit</i>¹⁴⁵ ofrohen trajnime 1-ditore ose me gjatë (professional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punëkërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet ndahen në katërgrupe: (1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike.</p> <p>Gjithashtu, kryhen trajnime nga Zyra e TIK, për përdorimin e sistemit LMS, për pedagogët, në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimit më efektiv të tij.¹⁴⁶</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UET ka angazhim të plotë të stafit akademik duke respektuar edhe standartet e ligjit të arsimit të lartë dhe udhëzimeve në fuqi për ngarkesën maksimale sipas titujve dhe gradave të personelit akademik efektiv dhe me kontratë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

¹⁴⁴ Statuti UET, Neni 6, pika 6.3 (Ref. Nr. 2); Trajnim mbi sistemin UET LMS (Ref. Nr. 46.4); Të dhëna mbi projektet, shkembimet, publikimet dhe veprimtaria kerkimore e stafit akademik (Ref. Nr. 43)

¹⁴⁵ Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020 (Ref. Nr. 3.1)

¹⁴⁶ Video-trajnime mbi sistemin Teams/LMS (Ref. Nr. 46.4)

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike¹⁴⁷. Institucioni ka në dispozicion salla të kapaciteteve të ndryshme duke akomoduar studentë sipas llojit të veprimtarisë dhe në përputhje me normativat në fuqi. Sipërfaqet e shfrytvzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510m² dhe 1515 vende. Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45m² dhe secila me nga 35 karrige. Salla 70 vendëshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100m² secila.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 5 laboratorë mësimorë informatike, dhe auditorë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS). Ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e ngarkuara nga pedagogu, leksione, matirale shtesë audio vizive etj.¹⁴⁸</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Mësimi në Master Shkencor në Infermieri zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, internet, projektorë dhe foni. Gjithashtu mësimi mund të zhvillohet dhe në laboratore të cilat janë të pajisura me të gjitha pajisjet e nevojshme për një mësimdhënie sa më efektive. Prej semestrit të II-te, të vitit akademik 2019-2020, mesimdhënia është zhvilluar online për shkak të masave kufizuese dhe situatës së shkaktuar nga pandemia globale Covid-19. Për këtë UET ka përdorur platformën e licencuar Microsoft TEAMS duke ofruar trajnime intensive për stafin dhe studentet mbi përdorimin e platformës.¹⁴⁹</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 5 laboratorë mësimorë informatike të cilët janë në dispozicion edhe për programet e studimit të ciklit të dytë, Lab 205 B me 23 PC dhe video projektor; Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit), Inovatioan Lab me 20 PC, dhe 43 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte</p>	<p>UET garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe bashkëpunon</p>

¹⁴⁷ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

¹⁴⁸ Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS; UET-LMS Guidë për pedagogun; UET_LMS Guidë për studentët (Referuar nr.46.1; 46.2 & 46.3)

¹⁴⁹ Vendime dhe Rregullore mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 (Ref. Nr. 5.1; 5.2; 5.3); Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS (Ref. Nr. 46.4)

të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	me institucione dhe organizata të tjera në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. ¹⁵⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e institucionit, e vendosur në godinën C dhe me një sipërfaqe prej 300m ² është e aksesueshme nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë, përfshirë dhe studentët e programit MSH në Infermieri. Në bibliotekë janë instaluar 14 pc nëpërmjet të cilave studentët aksesojnë bibliotekat on-line.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Biblioteka ka një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra dhe CD në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Akses i literaturës së programit nga studentët, garantohet nëpërmjet: 1. Literaturës fizike në bibliotekë, e cila pasurohet vit pas viti. Staf i akademik parashton kërkesën për blerjen e literaturës nëpërmjet plotësisht të formatit përkatës ¹⁵¹ ; 2. Aksesit në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia; ¹⁵² 3. Katalogut të librave elektronikë i krijuar nga biblioteka, i cili ka në gjuhë të huaj qindra tituj; 4. Materialeve të vëna në dispozicion nga titullarët në sistemin UET LMS.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Abonimi në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia, dhe kapacitete infrastrukturore në bibliotekë (PC, wi-fi) garantojnë përmbushjen e këtij kriteri. Akses i studentëve është pa pagesë.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e pajisur me PC/wi-fi në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat online të vëna në dispozicion nga institucioni. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të

¹⁵⁰ ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 5: Lista e subjekteve bashkëpunuese për praktikën profesionale (Ref. Nr. 32); Marrëveshjet e bashkëpunimit (Ref. Nr. 34.1 – 34.7); Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.1)

¹⁵¹ Dokumenti E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë (Ref. Nr. 45.2); Inventari i teksteve_MSH Infermieri (Ref. Nr. 45); Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës_Infrastruktura; (Ref. Nr. 42)

¹⁵² ANEKS: Tableat përmbledhëse – Tabela Nr. 17: Të dhëna për platformat on-line/strukturat IT/Biblioteka

	përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të dhënave, dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse. Veprimtaria dhe menyra e funksionimit dhe ofrimit të shërbimeve të Bibliotekës është e rregulluar me dokument të vecantë. ¹⁵³			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Pasurimi i fondit të bibliotekës është një proces i vazhdueshëm dhe objektiv i rëndësishëm i institucionit. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve. Procedurat e pasurimit të bibliotekës, janë të përcaktuara edhe në dokumentat që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit ¹⁵⁴ .			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hënë-Premte 9:00-20:00, e Shtunë 9:00:17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur. ¹⁵⁵			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sistemi nëpërmjet të cilit UET administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit është sistemi UMIS ¹⁵⁶ . Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, informimin automatik me anë të email-it ose me mesazhe për aktivitete të ndryshme, regjistrimi në kurse apo programe të ndryshme.

¹⁵³ Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës (Ref. Nr. 45.1)

¹⁵⁴ E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë; Dokumenti E. IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës; shembull procedure_blerje literature (Ref. Nr. 45.2; 45.1; 45.3); Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

¹⁵⁵ Dokumenti E.IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës (Ref.Nr.45.1)

¹⁵⁶ Manual i përdoruesit të sistemit UMIS (Ref. Nr. 46)

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administro informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi UMIS shërben kryesisht për evidentimin e angazhimit të pedagogëve në lëndët që mbulojnë sipas secilit semestër, ndërsa i gjithë aktiviteti i lidhur me procesin e mësimdhënies dhe komunikimit me studentët mbështetet në platformën UET LMS.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UET në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies, ka ndërtuar Sistemin e Menaxhimit të Mësimdhënies UET LMS. Sistemi i menaxhimit të mësimdhënies online (UET LMS) është standardi më bashkëkohor i përdorur nga gjithë universitetet prestigjioze në botë në informatizimin e procesit të mësimdhënies online. Aktualisht, sistemi UET LMS është azhurnuar më të gjithë informacionin bazë si: Janë regjistruar të gjithë studentët në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin; Janë regjistruar të gjitha lëndët që ofrohen në UET, në BA dhe MA, për çdo semestër; Janë regjistruar të gjithë pedagogët përgjegjës për çdo lëndë; Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit për çdo tipologji, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera; Sistemi jep mundësinë që përpara logimit çdo pedagog apo student të mund të shohë të gjitha lëndët që ofrohen në universitet; Sistemi mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemin nga studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij. Funksioni kryesor i këtij sistemi është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Platforma LMS (Learning Management System) është edhe një mjet eficient në dispozicion të organeve drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem. Në përfundim të çdo semestri nxirren statistikatat përkatëse për çdo pedagog në lidhje me përdorimin e LMS-së.</p>

<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Faqja Zyrtare e Universitetit European të Tiranës (UET) në web është: www.uet.edu.al. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organigramën; guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përdorimi i rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, shërbejnë gjithashtu, si një mjet komunikimi për të publikuar aktivitetet që zhvillohen në UET. UET ka ndërtuar faqen e re e cila është në gjuhën shqipe edhe në gjuhën angleze.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Buxhetimi financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe për zbatimin e këtij buxhetimi, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku percaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajiset me “Kërkesë për Lëvrime fondesh”, e miratuar nga Administratori. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat¹⁵⁷. Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të</p>	<p>Universiteti European i Tiranës kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. EEI shpk përgjatë vitit 2016-2017 ka marrë konsulencë financiare nga shoqëria “Deloitte Albania”. E.E.I. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj</p>

¹⁵⁷ ANEKS: Tabelat përmbledhëse – Tabela 18.1: Të dhëna mbi koston për student; Tabela 18.2: Të ardhura dhe financime të ndryshme

ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatit e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	UET ka raport auditit çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatese, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar Nenit 13 të Rregullores mbi 'Formën e studimit', përcaktohet se institucioni ofron programe studimi konform legjislacionit në fuqi, si rregull me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Procesi nga pranimi deri në dalje mbështetet në: legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloret përkatese ¹⁵⁸ , burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Informacioni për kriteret dhe

¹⁵⁸ Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve (Ref. Nr. 27.1)

	<p>procedurën e aplikimit publikohet online¹⁵⁹, në broshurën informuese (Guida UET), fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse¹⁶⁰.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit, kjo mbështetet në Nenin 42 të Rregullores së UET mbi ‘Të drejtat e studentit’. Një nga pikat e rregullores mësimore të MSH pohon se përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës. (Referuar pika 2, Pranimi në programin e studimit, Rregullorja mësimore MSH).</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat janë të kuptueshme dhe të aksesueshme, duke garantuar transparencë të plotë¹⁶¹. Kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online, dhe janë të përcaktuara dhe të zbatueshme sipas Nenit 35 të Rregullores së UET mbi ‘transferimin dhe mobilitetin e studentëve’ që përcakton të drejtën dhe procedurat mbi transferimet dhe kriteret e duhura. Ato i bëhen të ditura të interesuarve gjatë vizitës në institucion, sikurse dhe gjenden në aktet rregullatore të cilat i vihen në dispozicion studentëve sikurse janë të aksesueshme dhe në intranetin e UET.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Politikat e pranimit të studentëve kanë ardhur duke u konsoliduar. Megjithatë, vlen të theksojmë se në UET përpara fillimit të vitit akademik organizon takime pune për të vlerësuar çfarë ka nevojë të përmirësohet për vitin në vijim dhe ndryshimet e nevojshme në dokumentacionin rregullues duke ju referuar rregullores për Masterin Shkencor dhe Ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve nën-ligjore.</p> <p>Të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta, publikohen në faqen e UET, i bëhen të ditura të interesuarve gjatë kontakteve me ta, sikurse dhe reflektohen në dokumentet respektive të listuara në kriterin 1 dhe 3 më lart.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Institucioni i jep mundësinë çdo të interesuari të njihet më në detaj me programet dhe kurrikulat që ofron. Informacioni shpërndahet përmes rrugëve të ndryshme të komunikimit. Informimi kryhet vazhdimisht përmes Zyrave të Kujdesit ndaj Studentit, gjimnaz-tureve të organizuara gjatë vitit, fushatave publicitare të organizuara nga zyra e PR, informimeve dhe takimeve të hapura në universitet me gjimnazistët e ftuar nga gjimnaze të ndryshme, përmes broshurës së UET, si në formatin hard-copy, po ashtu edhe online. Gjithashtu në kuadër të fillimit të vitit të ri akademik, UET zhvillon Javën e Orientimit. Kjo është një traditë që UET e zhvillon çdo vit për të ndihmuar</p>

¹⁵⁹ <http://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/>

¹⁶⁰ Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28); Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12); Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik (Ref. Nr. 27.2); Rregullore mësimore MSH (Ref. Nr. 7)

¹⁶¹ Rregullore UET, Neni 42 (Ref.Nr.5)

	studentët e rinj që të njihen më shumë me programet, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. ¹⁶²			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	I gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit ¹⁶³ dhe aktet e tjera rregullatore. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me ecurinë mësimore të studentit. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Përmes koordinatores së departamentit, studenti mund të tërheqë fishën studentore, e cila i jep mundësi të informohet për vlerësimin për secilën lëndë të zhvilluar deri në periudhën aktuale, si dhe për numrin e krediteve të akumuluar. Institucioni vë në dispozicion të plotë informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Procedura të cilat janë të përcaktuara nga Kreu V i Rregullores së UET mbi Kontrollin dhe vlerësimin e dijes dhe veçanërisht, Neni 23 mbi sistemin e vlerësimit dhe Neni 29 mbi kalimin në vitin pasardhës.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, UET-i informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve ose studimeve të pjesshme. Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, në bashkëpunim me Departamentin, informojnë studentët dhe bëjnë vlerësimet paraprake për studentët e interesuar për të transferuar studimet. Institucioni sipas Nenit 35 të Rregullores së UET ka të përcaktuar procedurat dhe kriteret mbi transferimet dhe mobilitetin e studentëve. UET pranon transferime të studentëve nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera ¹⁶⁴ .
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Mbështetur në Kreun V të Rregullores së UET dhe në Nenin 23 dhe 24 mbi Mënyrën e Kontrollit dhe Sistemin e Vlerësimit, Institucioni ka të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programet e studimit. Në fillim të vitit akademik, studentit përmes koordinatores së departamentit i vihet në dispozicion

¹⁶² Komunikimi i integruar i marketingut (Ref. Nr. 51); Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online (Ref. Nr. 48)

¹⁶³ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri (Ref. Nr. 7)

¹⁶⁴ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Kreu VII (Ref. Nr. 5)

	silabusi për çdo lëndë të programit të studimit. Pjesë e silabusit është edhe mënyra e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. ¹⁶⁵			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Dokumenti për punimin e diplomës, pjesë e Broshurës së Dokumenteve UET, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës të Departamentit, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimin konkret të punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen ¹⁶⁶ . Gjithashtu studentët njoftohen nëpërmjet e-mailit për çdo veprimtari akademike, nga koordinatori e Departamentit.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Kreu VIII i Rregullores së UET mbi Këshillimin e Studentëve përcakton qartë procedurat dhe aktivitetet që duhet të organizohet nga institucioni në lidhje me informimin e studentëve. Posaçërisht Neni 36 mbi Orientimin e studentëve përcakton se: Çdo pranverë UET-i organizon grupe pune, të përbëra nga pedagogë dhe studentë, të cilët vizitojnë shkollat të mesme në qytete të ndryshme të vendit (Gjimnaz tour) për t'u bërë të njohur maturanëve programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata të bëjnë një zgjedhje të mirinformuar dhe të ndërgjegjshme. Gjithashtu UET zhvillon Open Days ku maturanët mund të vizitojnë nga afër institucionin e të ndjekin edhe orë të caktuara mësimi. Në kuadër të fillimit të vitit të ri akademik, UET zhvillon Javën e Orientimit. Kjo është një traditë që UET e zhvillon çdo vit për të ndihmuar studentët e rinj që të njihen më shumë me programet, pedagogët, ambientet e universitetit dhe disa nga rregullat bazë të universitetit dhe jetës studentore. Mbledhjet e hapura të departamenteve shërbejnë gjithashtu për informimin dhe diskutimin me studentët lidhur me programet e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit;

¹⁶⁵ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, (Ref. Nr. 7); Silabuset e lëndëve (Ref. Nr 19).

¹⁶⁶ Dokumenti B.II Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. Nr. 10)

	<ul style="list-style-type: none"> • Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit; • Rregullores mësimore të programit të studimit. <p>Mbështetur edhe në nenin 37 mbi Tutoriatin dhe këshillimin akademik, Këshillimi akademik është një shërbim që iu ofrohet studentëve të ciklit të dytë dhe synon t'i ndihmojë ata të identifikojnë dhe të arrijnë qëllimet e tyre akademike.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij.¹⁶⁷ Çdo fillim semestri atyre u vihet në dispozicion program i lëndëve që ofrohen (silabuset). Këto programe u dërgohen elektronikisht nga koordinatori dhe departamenti, si dhe gjenden të printuara në librarinë e universitetit. Silabuset dhe materialet e leximit për secilën lëndë hidhen edhe në sistemin LMS (Learning Management System). Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit www.uet.edu.al.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Neni 37 i Rregullores së UET: Tutoriati dhe këshillimi akademik, siguron jo vetëm informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit por edhe mbështetjen institucionale për orientimin në Tregun e Punës. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, e cila e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit¹⁶⁸; • Bordeve të tregut të punës – të cilat shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës¹⁶⁹; • Organizimit të panairëve të punës dhe aktivitete me aktorë nga tregu i punës¹⁷⁰; • Dërgimit të njoftimeve tek studentët mbi mundësitë e ndryshme për punësim.
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Që në momentin e interesimit e deri në përfundim të studimeve, studentëve i vihet në dispozicion informacioni i nevojshëm mbi proceset mësimore. Një nga detyrat e koordinatorëve të departamentit është mbajtja e kontakteve të rregullta, njoftimeve elektronike dhe me telefon, me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit. Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatorëve të departamenteve dhe shpallet në këndin e njoftimeve¹⁷¹ (referuar Neni 21, Orari i mësimin, Rregullore UET). Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS.</p>

¹⁶⁷ Rregullore e programit të studimit_MSH Infermieri, Pika 3 (Ref. Nr. 7)

¹⁶⁸ Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12)

¹⁶⁹ Bordi i Tregut të Punës 2018-2019 (Ref. Nr. 12.1)

¹⁷⁰ Poster_Panairi i punës 2019 (Ref. Nr. 12.2); Dita e Biznesit në UET; <http://uet.edu.al/new/dita-e-biznesit-ne-uet/>; <http://uet.edu.al/new/edukimi-financiar-sa-te-informuar-jane-te-rinjte-sot/>

¹⁷¹ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 21 (Ref. Nr. 5)

<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it. Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjërë dhe i plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të zhvillimit akademik të studentit. Siç përcaktohet nga Neni 37: Tutoriati dhe këshillimi akademik: 37.2 Këshillimi akademik është një proces në shërbim të studentëve, për të sqaruar çdo paqartësi ose vështirësi që mund të haset nga studenti për shlyerjen e detyrimeve në lëndët që ai frekuenton. Ky informacion tashmë është edhe pjesë e platformës LMS, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas silabusit.</p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit ben te mundur pasqyrimin dhe administrimin e informacionit, dokumentacionit duke e vënë atë në dispozicion të studentit, i cili e akseson në çdo kohë; të gjitha dokumentat ndodhen dhe mund të shkarkohen sa herë është e nevojshme, në sistemin e menaxhimit UMS në formën online. Studenti merr informacion lidhur me notat, vlerësimet dhe pikët nëpërmjet këtij sistemi. Nga ana tjetër, aktiviteti mësimor i studentëve, mund të aksesohet nga zyrat e IT dhe t'i vihen në dispozicion pedagogut e studentit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Për secilin program studimi, institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me cilësinë në hyrje dhe dalje, punësimin gjatë dhe pas diplomimit, etj. Të dhënat janë të detajuara dhe në bazë të profileve për secilin program studimi. Duke qenë se në programin MSH Infermieri, sapo është diplomuar brezi i parë, të dhënat perdiesohen cdo vit si për cilësinë në hyrje të studentëve dhe informacion mbi punësimin aktual të tyre¹⁷².</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para</p>	<p>Universiteti disponon statistika të plota mbi ecurinë e studentëve. Duke përfshirë rekorde të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e</p>

¹⁷² Tabela përmbledhëse për punësimin real të studentëve (Ref. Nr. 29); Cilesia ne hyrje dhe dalje (per programin (Ref. Nr. 27)

përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për secilin program studimi. Në programin MSH Infermieri, ecuria e deri tanishme është pozitive dhe nuk ka raste të studentëve që kanë ndërprerë studimet.			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat për ecurinë e studimeve dhe rekordet e studentit. Këto të dhëna gjenden në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Kujdesit të Studentit. ¹⁷³			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Përbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMS.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Programi MSH Infermieri, është hapur në vitin akademik 2018-2019 dhe po hartohet një raport analitik mbi cilësinë në dalje dhe shkallën e punësimit. Sqarojmë se kjo është një praktikë që ndiqet nga institucioni për programet e tjera të studimit. Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontaktet me studentët e diplomuar nëpërmjet strukturës së UET Alumni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Studentët përfaqësohen në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. UET-i inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre¹⁷⁴. Ndër strukturat kryesore përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. • Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve. • Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve. • KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. • Mbledhjet e departamenteve, një në muaj është e hapur për studentët.

¹⁷³ Dokumenti E-I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9)

¹⁷⁴ Statuti UET, Neni 16, 19 dhe 51 (Ref. Nr. 2)

<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve garantohet si në mënyrë të drejtpërdrejtë (përfaqësimi në strukturat e analizuar në Kriterin 1) ashtu edhe në mënyrë periodike, nëpërmjet zhvillimit të fokus grupeve, pyetësorëve online dhe kërkesave të studentëve. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit MSH Infermieri, është pjesë e GVB të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti.</p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programet e studimit i nënshtrohen në mënyrë periodike rishikimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar. Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimeve përkatëse të MAS-it dhe në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, Universiteti European i Tiranës pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara në këtë dokument. Studenti duhet të ndjekë në UET, jo më pak se 30% të ECTS-ve teorike, si dhe diplomën dhe praktikën profesionale. Në çdo rast studentit duhet të ndjekë në UET, jo më pak se 25% të ECTS-ve teorike, si dhe diplomën dhe praktikën profesionale. Studenti ka të drejtë të aplikojë vetëm një herë për transferim lëndësh dhe kreditesh¹⁷⁵.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Zhvillimi i fokus grupeve, pyetësorëve online dhe mbledhjeve të hapura të departamenteve shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme¹⁷⁶ sikurse dhe në silabusin e secilës lëndë.¹⁷⁷ Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashitë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.¹⁷⁸</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.6

¹⁷⁵ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Kreu VII, Neni 35 (Ref. Nr. 5); Statuti UET, neni 37 (Ref. Nr. 2); Dokumenti D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve,(Ref. Nr. 28)

¹⁷⁶ Rregullore e Universitetit European të Tiranës, Neni 24, 27 dhe 32 (Ref. Nr. 5);

¹⁷⁷ Format i silabusit cikli i pare dhe dytë (Ref. Nr. 19.1)

¹⁷⁸ D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve (Ref. Nr. 40.1)

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Aktualisht UET ka ngritur dhe ka punuar intensivisht për të konsoliduar strukturën e kërkimit shkencor, të mbështetur në Programin e madh kërkimor “Shqipëria Inovative 2015-2020”, të përbërë nga 7 projekte kërkimore, brenda të cilave integrohen drejtimet e mëdha kërkimore dhe akset kërkimore individuale të profesorëve të UET. Personeli akademik është nxitur të marrë pjesë në projekte kërkimore, konferenca e aktivitete të tjera shkencore, të publikojë rezultatet e punës kërkimore, duke përfituar edhe mbështetje financiare përmes akordimit të granteve kërkimore vjetore. Institucioni ka nxitur dhe mbështetur anëtarët e personelit akademik që të avancojnë në shkallët e kualifikimit të tyre akademik, duke krijuar lehtësira për t’iu përgjigjur përmbushjes së kërkesave ligjore për pjesëmarrje në konferenca, publikimin e artikujve shkencorë apo monografive, mobilitetin e personelit në institucione të tjera të arsimit të lartë ose ato kërkimore jashtë vendit. Gjatë gjithë vitit, në UET organizohen konferenca e aktivitete të ndryshme për personelin akademik.</p> <p>Gjithashtu pjesëmarrja në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor shprehet qartë dhe në statutin e UET neni 45.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Sipas Planit strategjik 2021-2025, “Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore “pika 3, UET synon nxitjen e sa më shumë bashkëpunimeve e kooperime dypalëshe apo shumëpalëshe të shoqatave dhe grupeve të studentëve me universitete analoge në Shqipëri, rajon, vendet e BE dhe më gjerë. Në Planit strategjik 2015-2020, “Prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar”, pika 3, thuhet se UET synon organizimin dhe ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët.</p> <p>UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. (Referim Shtojces mbi institucionet e praktikës për Masterin Profesional dhe Shkencor)</p> <p>Programi 250+ është krijuar gjithashtu për të rritur bashkëpunimin e UET dhe të këtij programi studimi me kompani të llojeve të ndryshme. Ky program synon që nëpërmjet bashkëpunimit me këto kompani të bëhet i mundur integrimi i studentëve tanë në internshipe dhe në punësimin e tyre. Ky bashkëpunim synon rritjen e njohurive dhe aftësisimit profesional, shkencor e praktik të studentëve që ndjekin këtë program studimi</p>

	duke patur këto kompani prioritare për të dërguar studentët në praktika profesionale dhe në përfshirjen e drejtuesve të këtyre kompanive në leksione të hapura në programet Master duke përcuar praktikën dhe eksperiencën e tyre tek studentët. UET ka marrëveshje partneriteti të shumta me institucione të huaja të arsimit të lartë në Europë, Kinë, Australi e Amerikë. Keto marrëveshje konsistojnë në shkëmbime semestrale si dhe projekte të perbashketa të studentëve të UET me insitucionet e huaja.			
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Ashtu sikurse personeli akademik merr vetë pjesë në aktivitete kërkimore shkencore, nxit edhe studentët të bëjnë të njëjtën gjë, të marrin pjesë aktive në punime shkencore, e të mësojnë si të mbrojnë tema shkencore.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Sipas Planit strategjik 2021-2025 pika 1 prioritet të madh ka kërkimi shkencor ku UET duhet të shndërrohet në një qendër të rëndësishme kombëtare dhe rajonale në zhvillimin dhe cilësinë e kërkimit shkencor, në një institucion që kërkimin shkencor e ka prioritar në aktivitetin e përditshëm të saj, që shmang praktikën e gabuara të një “kërkimi shkencor formal apo fasadë” duke u përqëndruar në kërkimet shkencore teorike dhe aplikative me prioritet “studimet shqiptare e rajonale” në funksion të zhvillimit ekonomik, social e kulturor. UET ka revistën e tij shkencore, MEDICUS journal, hap shpesh thirrjet për publikimin e artikujve të kërkimeve shkencore, rishikimeve të literaturës, studimeve të rasteve apo atyre krahasimore, duke nxitur publikimin e tyre prej stafit akademik apo studenteve në anglisht, me qëllim ndërkombëtarizimin e revistës.			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Studentet motivohen nga personeli administrativ dhe akademik për të marrë pjesë aktive në studime inovative, të cilat mund të kenë një pikësynim në ndihmë të vetë institucionit apo të aplikohen në jetën e përditshme në të ardhmen.			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Ne kuadër të realizimit të diplomës, çdo student ka në dispozicion një pedagog udhëheqës i cili e orienton lidhur me mënyrën e punimit, kryerjen e analizave, matjeve, përmbledhjes së literaturës së konsultuar dhe kryerjes së studimit, pas kësaj në momentin e përpunimit të rezultateve, atij i qëndron pranë edhe pedagogu i Metodologjisë së Kërkimit Shkencor, por edhe zyra e IT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UET ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional duke përfshirë edhe programet e studimit për Infermieri. Gjithashtu, lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare zhvillohet në kuadër institucional ndaj të dhënat e këtij seksioni do të jepen në nivel insitucional.</p> <p>Aktualisht UET gëzon 95 marrëveshje (memorandum bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë. Nga ana tjetër UET gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare, publike dhe jo publike.¹⁷⁹</p> <p>UET synon të bëhet një qëndër e rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare e rajonale në kooperimin akademik universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues, dhe promovimin e vlerave zhvilluese e qytetare të arsimit të lartë.</p> <p>UET synon që të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të Europës jug-lindore, vendeve të bashkimit European dhe më gjerë vendeve anëtare të OECD-së.</p> <p>UET synon organizimin dhe ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët.</p> <p>UET synon përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standarteve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboreve, etj. UET bashkëpunon me organizma shkencorë kombëtarë, për të realizuar rritjen e aktiviteteve dhe mundësuar angazhim të stafit dhe studentëve të MSH konkretisht dhe këto aktivitete me pas pasqyrohen në zyren perkatese.</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik tek studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. Studentët që në nivelin e parë të studimeve në ciklin bachelor aftësohen të bëjnë kërkime shkencore. Më pas në ciklin e dytë të studimeve këto aftësi përmirësohen dukshëm duke i përgatitur studentët për ciklin e tretë.</p>

¹⁷⁹ Lista e marreveshjeve UET (Ref. Nr. 34)

<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaja. Ky kriter permbushet, Plani strategjik 2021-2025, pika 4. Studentët përfshihen në projekte të ndryshme kërkimore, më shumë kemi patur raste të projekteve kërkimore vëndase e më pak të huaj, por sapo universiteti arrin një marreveshje apo realizon pjesëmarrje në një projekt, e vë atë në dispozicion të studentit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. Ky kriter permbushet, Plani strategjik 2015-2020; 2021-2025, pika 4. Kërkuesit shkencorë të huaj janë gjithashtu të mirëpritur në universitet, duke u vënë atyre në dispozicion të gjitha të dhënat që ata mund të aksesojnë, por nuk kanë qënë të shpeshta mundësitë për ta bërë këtë shkëmbim, duke qënë se programi është hapur në vitin 2018.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. Ky kriter permbushet, Plani strategjik 2021-2025, pika 4.</p> <p>Shkëmbimet nderkombetare studentore jane nje nder politikat e preferuara te institucionit i cili e ndermerr kete mobilitet sa here shfaqet mundesia per aktivitete nderkombetare.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Njësia kryesore/bazë është Departamenti (Neni 5, Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës). Kreu II Struktura Organizative e Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës përcakton njësitë përbërëse të strukturës dhe se si ato janë të ndërlidhura me njera-tjetrën në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të koordinimit të aktiviteteve në funksion të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Një ndër njësitë kryesore që asiston në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshin stafin akademik është Zyra e Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim misioni i së cilës është të ndihmojë në rritjen e misionit akademik dhe kërkimor të UET-it. Në sajë të programeve të shkëmbimit Erasmus+ stafi i universitetit dhe stafi i përfshirë në programin PoSIG ka pasur mundësi të fitojë eksperiencë ndërkombëtare përmes mësimdhënies në universitete perëndimore, por edhe përmes pedagogëve të ftuar nga këto universitete për të dhënë mësim në UET.</p> <p>Projektet Erasmus jane nje nga format sesi UET fton stafin akademik dhe studentet te behen pjese e shkëmbimeve, duke I dhene atyre mundesine te studiojne jashte ne nje nga universitetet partnere si dhe studenteve te atij universiteti te vijne ne institucion per nje semester si kohezgjatje, nderkohe qe ne rastin e stafit akademik kjo nenkupton aplikim te</p>

	mesimdhënies ne gjuhen angleze ne universitetet partnere ne lendet e ekspertizes per 2 jave si dhe ftese per stafin e huaj tek ne.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Njësia e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në UET është zyra e Kujdesit ndaj Studentit ¹⁸⁰ . Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë përkatëse për çështje akademike dhe studentore ¹⁸¹ . Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Kombimimi i aktivitetit të zyrave administrative dhe sistemit të këshillimit në bazë të secilit department (referencë kriteri 1), janë tregues të ngritjes dhe mirëfunksionimit të një sistemi të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët. Krahas këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes tutoriatit dhe këshillimit akademik, studenti në UET mund t'i drejtohet edhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyrës së Karrierës, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë UET-it. Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazhdimisht 'fokus grupe' për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen, por edhe nevojave dhe ndihmës ndaj studentëve që kanë mbetur prapa me studimet, duke u ofruar mbështetjen e nevojshme.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, sikurse ruan edhe kontaktet pas diplomimit, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik, por janë plotësues të njëra-tjetrës.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh,	Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me

¹⁸⁰Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12)

¹⁸¹ Dokumenti A-V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik (Ref. Nr. 27.2)

<p>përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2009 kur u diplomuan studentët e parë, në UET është ngritur edhe shoqata Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t’iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në vend e më gjerë.¹⁸²</p> <p>Në këtë kuadër, studentë Alumni janë të përfshirë në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve.</p> <p>UET organizon çdo vit takimim me UET Alumni. Të diplomuarit zgjedhin një kryetar dhe nëpërmjet tij UET mban lidhje me ta, për të parë ecurinë e tyre dhe arritjet në sferën profesionale, mbi bazë të së cilës gjykohet sesa të suksesshëm kemi qenë me formimin profesional të studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹⁸² Tabela përmbledhëse për punësimin real të studentëve (Ref. Nr. 29); Analiza e departamentit përgjegjës për arritjen e objektivave formues (seksioni 5. Punesimi i studenteve) (Ref. Nr. 38); <http://uet.edu.al/new/uet-alumni-10-vite-me-pas/>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>UET i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar që veprimtaria e tij jo vetëm është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, por gjithashtu që objektivat strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit vazhdojnë të qëndrojnë në themel dhe të drejtojnë punën e përditshme të strukturave drejtuese dhe personelit.¹⁸³</p> <p>Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet.¹⁸⁴</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë funksionon nëpërmjet këtyre strukturave:</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), i cili e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve <i>ad hoc</i>, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit¹⁸⁵. Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit.</p> <p>Ngritja e organeve Këshilluese si Bordet e Tregut të Punës, sikurse dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm, i përgjigjet gjithashtu nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm në drejtim të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë.</p> <p>Strukturë tjetër e rëndësishme në sigurimin e brendshëm të cilësisë është dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), roli i së cilës është të zhvillojë politikat, strategjitë, proceset dhe udhëzimet, në funksion të rritjes së cilësisë në UET, si dhe të monitorojë zbatueshmërinë korrekte ndaj tyre nga njësitë akademike dhe administrative.¹⁸⁶</p>

¹⁸³ Statuti UET, Neni 11&16 (Ref. Nr. 2); Rregullore UET, Neni 6 (Ref. Nr. 5); Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

¹⁸⁴ Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”, Neni 103 (Ref. Nr. 53); VKM Nr. 531, date 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë” (Ref. Nr. 53.2)

¹⁸⁵ Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC_Tabela 24 Aneks (Ref. Nr. 30); Urdhër mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)

¹⁸⁶ Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.5 (Ref. Nr. 8)

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, monitorimit nga ana e strukturave drejtuese, ZCS, KSBC-së, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore.</p> <p>Universiteti European i Tiranës i ëshë nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe akreditimin periodik Institucional, me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 5 vite akademike¹⁸⁷.</p> <p>Po ashtu, në kuadër të promovimit dhe përmirësimit të cilësisë, i janë nënshtruar procesit të akreditimit në mënyrë periodike dhe programet e studimit¹⁸⁸.</p> <p>Në këtë drejtim, në UET është zbatuar procesi i kontrollit të ligjshmërisë i ushtruar nga MASR në vitin 2014, sipas së cilit UET plotësonte standardet dhe kriteret ligjore për ushtrimin e aktivitetit akademik; janë zhvilluar vizita monitoruese të MASR mbi përmbushjen e kapaciteteve akademike dhe infrastrukurore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Veprimtaria e KSBC mbështetet në dokumentet e saj strategjike¹⁸⁹, dhe zhvillohet e organizuar sipas një plani kalendar (Plani i veprimit)¹⁹⁰ të përvitshëm, në të cilin programohen sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet dhe gjetjet përkatëse. Në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e njëjve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njëjve të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet.

¹⁸⁷ Licencime dhe akreditime: VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë UET”; VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin e Universitetit European të Tiranës”; Certifikatë akreditimi UET (Ref. Nr. 54)

¹⁸⁸ Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga departamenti_Tabela 3 Aneks (Ref. Nr. 26)

¹⁸⁹ Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3)

¹⁹⁰ Plani veprimit KSBC (Ref. Nr. 30.1)

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>KSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit.</p> <p>Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm kanë departamentet si njësia përgjegjëse për programin e studimit, ku përgjegjësit e grup-lëndëve/koordinatorët¹⁹¹ e programeve kanë detyra specifike që lidhen me çështjet e rishikimit të kurrikulës, silabuseve dhe literaturës në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe standardet dhe Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së UET.¹⁹²</p> <p>Bordet e Tregut të Punës kanë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm pasi reflektojnë dinamikën dhe kërkesat që vijnë nga tregu. Këto rekomandime bëhen bazë për ndryshime në kurrikula në funksion të përshatjes sa më mire me këto kërkesa.¹⁹³</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar¹⁹⁴. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Rektorati, sikurse dhe në nivel departamenti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UET përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktivitetëve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve¹⁹⁵.</p> <p>KSBC njëherazi, rekomandon detyra, zbatimin e cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe nga vet Komisioni.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Ky kriter plotësohet pasi rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse sikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit, etj.¹⁹⁶</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktivitetëve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë¹⁹⁷. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në</p>

¹⁹¹ Vendimi për emërimin e Koordinatorëve të programeve të studimit (Ref. Nr. 36)

¹⁹² Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3)

¹⁹³ Dokumenti E.VIII. Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave, Pika E.VII.4.1 (Ref. Nr. 13)

¹⁹⁴ Metodologjia e punës së KSBC_Provimet (Ref. Nr. 30.5); Format Raporti_Provimet (Ref. Nr. 30.6)

¹⁹⁵ Shpërndarja e relacionit të KSBC për monitorimin e silabuseve (Ref. Nr. 30.7)

¹⁹⁶ Format i relacionit për monitorimin e silabuseve (Ref. Nr. 37)

¹⁹⁷ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.3-7 (Ref. Nr. 8)

	sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi nga KSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor metoda të tërthorta, të drejtpërdrejta si dhe instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Disa prej metodave që UET përdor për kryerjen e vlerësimeve përfshijnë monitorimin e elementëve të lidhur me proceset akademike si provimet, silabuset, literatura e përdorur, etj ¹⁹⁸ . Një vend të veçantë zë dhe përfshirja e studentëve në këto procese. Në strukturën e KSBC është një përfaqësues i Këshillit të Studentëve ¹⁹⁹ . Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale	UET në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: <ul style="list-style-type: none"> - Teste të standardizuara; - Dëgjime në auditor; - Vlerësimi me pikë; - Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module; praktikë;

¹⁹⁸ Plani veprimit KSBC (Ref. Nr. 30.1)

¹⁹⁹ Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Ref. Nr. 30); Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)

<p>apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; - Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës. <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eperi (Përgjegjës/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi.²⁰⁰ Në kushtet e vijimit të procesit akademik online përmes platformave UET LMS dhe Microsoft Teams, sipas Vendimit të Senatit Akademik²⁰¹, monitorimi i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve është mundësuar nga Zyra e IT në UET nëpërmjet raporteve të vazhdueshme mbi aksesimin e platformave nga stafi akademik/studentët dhe prezencën në mësim, mbi kohëzgjatjen e orëve mësimore, etj. Lidhur me cilësinë dhe metodologjitë e mësimdhënies, orët mësimore janë monitoruar nga Përgjegjësi i Departamentit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program</p>	<p>Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët.²⁰²</p> <p>Metodat e tërthorta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve. - Sondazhe: të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit. - Pyetje konceptuale. - Intervista. <p>Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesëve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si dhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

²⁰⁰ G.III.4.1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref. Nr. 30.8)

²⁰¹ Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 (Ref. Nr. 5.1)

²⁰² G.III.4.2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të interesuar në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit, sigurohet përmes disa formave të parashikuara në politikat dhe aktet rregullatore të procedurave të brendshme të UET.</p> <p>Një nga këto politika, është ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm²⁰³ i përgjigjet nevojës së Universitetit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm.</p> <p>Gjatë periudhës 2016-2019, UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë: projekti TEMPUS “ENCHASE” dhe projekti Erasmus+ QAINAL.²⁰⁴ Aspektet pozitive të përfshirjes në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.²⁰⁵</p> <p>Lidhur me sigurimin e cilësisë, ka patur gjithashtu shkëmbime të stafit akademik dhe administrativ – me fokus në mësimdhënie dhe trajnim – në kuadër të projektit Erasmus+ KA1²⁰⁶.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në aktet rregullatore të Universitetit.²⁰⁷ Po ashtu, në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë ka detyrime dhe përgjegjësi konkrete institucionale çdo njësi: departamenti, koordinatori i programit, zyra e karrierës, sekretaria mësimore, stafi akademik.²⁰⁸ Sinkronizimin e veprimtarisë së secilës njësi e garanton KSBC.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe</p>	<p>Në dokumentin që rregullon veprimtarinë lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë përcaktohen detyrat dhe</p>

²⁰³ Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Ref. Nr. 30); Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4)

²⁰⁴ Fisha e projektit ENCHASE (Ref. Nr. 30.9); Fisha e projektit QAINAL (Ref. Nr. 30.10)

²⁰⁵ Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 30.3)

²⁰⁶ Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43.1)

²⁰⁷ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

²⁰⁸ Statuti i UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6 (Ref. Nr. 2); Aneks: Për përcaktimin e detyrave të koordinorit të programit të studimit (Ref. Nr. 36)

kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar ²⁰⁹ . Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Ky kriter përmbushet duke qënë se në përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC, që kryen proceset ciklike të vlerësimit, meren parasysh kriteret e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetencat profesionale; - Paanshmëria; - Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin; - Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; - Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET; - Etj.²¹⁰ 			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Ky kriter përmbushet nëpërmjet angazhimit të ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC-së, nëpërmjet takimeve me Bordin e Tregut të Punës ²¹¹ . Edhe pjesëmarrjet që UET ka patur në projektet e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë, janë tregues i angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë. ²¹²			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani calendar, Planit të veprimit, të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet e detajuara dhe raportet përmbledhëse me gjetjet përkatëse. ²¹³

²⁰⁹ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

²¹⁰ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.7 (Ref. Nr. 8)

²¹¹ Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Ref. Nr. 30); Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC (Ref. Nr. 30.4); Bordi i Tregut të Punës (Rev. Nr. 12.1)

²¹² Fisha e projektit ENCHASE (Ref. Nr. 30.9); Fisha e projektit QAinAL (Ref. Nr. 30.10)

²¹³ Plani veprimit KSBC (Ref. Nr. 30.1)

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Duke marrë në konsideratë faktin se raportet e KSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat Raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë. Raporti në tërësi i shpërndahet drejtuesëve, ndërsa në departamente diskutohen vetëm ato pjesë të raporteve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë departament. Në ato raste kur të dhënat vlerësohen se kanë një sensibilitet të lartë, rastet trajtohen nga strukturat drejtuese me personin konkret në takime individuale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Të dhënat e përftuara nga vetëvlerësimet periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situates por edhe për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion drejtuesëve të Universitetit, si dhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të folloë-up, gjatë të cilit drejtuesit e Universitetit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik²¹⁴. Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet pyetësorëve, janë marrë masa, të cilat variojnë nga zhvillimi i seminareve trajnuese dhe deri tek masat konkrete për pedagogët të cilët mund të kenë shfaqur problematikë të vazhdueshme.</p> <p>Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme të fokusuar kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor; - Inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen në aktivitete zhvilluese, si brenda ashtu dhe jashtë vendit; - Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të shkëmbimit të stafit nëpërmjet përfshirjes në programin Erasmus+.
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UET, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të grup-lëndëve²¹⁵ e koordinorit</p>

²¹⁴ G.I.12.1 Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik (Ref. Nr. 41)

²¹⁵ Statuti i UET, Neni 11, 16, 20.5, 20.6 (Ref. Nr. 2);

	të programit ²¹⁶ , të strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave ²¹⁷ , Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. ²¹⁸			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përfshirja e tyre në strukturat e garantimit të cilësisë por edhe në mënyrë të tërthortë duke qënë se veprimtaria i bëhet e ditur si stafit akademik ashtu edhe studentëve. Informacioni për studentët shpërndahet nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloreve; - Studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (KSBC, Senatin Akademik); - Këshillit të studentëve; - Javës së orientimit (e cila zhvillohet në fillim të vitit akademik). 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²¹⁶ Aneks: Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit të studimit (Ref. Nr. 36)

²¹⁷ Dokumenti E. VII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave (Ref. Nr. 13)

²¹⁸ Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Infermieri” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Cilësia e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, i cili ka grada e tituj shkencorë, konform përcaktimeve ligjore, eksperiencia në mësimdhënie dhe përvoja profesionale në fushën e shkencave mjekësore. Përputhje e ekspertizës së secilit pedagog me lëndët ku ai/ajo është titullar.
2. Personel akademik me përvojë shumëvjeçare pune praktike në Qendra Spitalore/ Institucione Shëndetësore që orienton infermierin teknikien drejt detyrave praktike.
3. Mësimdhënia e mbështetur në metoda bashkëkohore dhe sistem e-learning në shërbim të studentëve dhe personelit akademik.
4. Bashkëpunimi i ngushtë me aktorët e tregut të punës, dhe kontributi i tyre në përmirësimin e kurrikulës që do të reflektohet pas akreditimit, konform përcaktimeve në kuadrin ligjor, si edhe në mësimdhënie për tema specifike të ekspertizës së tyre profesionale, sjell një harmonizim mjaft të mirë të njohurive teorike me ato praktike dhe bën që kurrikula t’i përgjigjet më mirë kërkesave të tregut të punës. Njëkohësisht, ky bashkëpunim lehtëson punësimin e studentëve pas diplomimit.
5. Përvoja e studentëve të regjistruar në programin e studimit, ku shumica e studentëve janë të punësuar në profesionin e tyre, lehtëson mësimdhënien interaktive dhe mundëson shkëmbimin e eksperiencave praktike në seminare.
6. UET ka garantuar praktikat mësimore dhe të orëve praktike/laboratorike në Institucionet Spitalore me të cilat ka marrëveshje, pavarësisht kushteve të vështira të krijuara prej pandemisë.

Pikat e dobëta

1. Zhvillimi i mësimin online me për një periudhë afro një vit e gjysëm akademik ka ndikuar në aftësitë e studentit për të përfituar maksimalisht nga mësimdhënia. Ndonëse mësimdhënia është zhvilluar me korrektësi në platformën Teams, për të zbutur efektin që ka mungesa e kontaktit të drejtpërdrejtë me pedagogun në auditor dhe rritur motivimin dhe aktivizimin e studentëve janë zhvilluar praktikat në spitale në Institucionet partnere duke respektuar protokollet anti-Covid. Gjithashtu në semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021 kur situata ka qenë më e përmirësuar janë zhvilluar disa aktivitete në Spitale/Klinika me studentët duke i përfshirë në grupe të vogla me rotacion.
2. Specifika që ka Fakulteti i Shkencave Mjekësore bën që stafi i punësuar full time për shkak të punësimit edhe në spital nuk është gjithë kohën i pranishëm në Institucion, çka ka kërkuar më shumë punë në menaxhimin e detyrave. Kjo kompensohet me benefitin që sjell përvoja e tyre në auditor, përditësimi që ata kanë me rastet klinike dhe aftësitë praktike që transmetojnë tek studentët..

3. Ka një numër të pakët tekstesh mjekësore bashkëkohore për infermierë në gjuhën shqipe. FSHMT ka përdorur tekste në gjuhën angleze, krahas leksioneve të pedagogëve. Vështirësitë e disa studentëve për të lexuar në gjuhën angleze mjekësore janë tejkaluar me anë të leksioneve të pedagogëve. Numri i teksteve të botuara në gjuhën shqipe specifike për infermierët dhe menaxhimin infermior të sëmundjeve është i vogël, ndonëse ka tekste për mjekët.
4. Numri i vogël i studentëve që ndoqën studimet në vitin akademik 2018-2019, për shkak të licensimit në muajin Tetor, u ndoq nga një rritje e numrit të studentëve që u regjistruan në vitin pasardhës. Ka pasur rritje të numrit të studentëve (aktualisht në Masterin e Shkencave Infermieri ndjekin studimet 15 studentë), por ende numrat janë të vegjël. Ky numër studentësh shpjegohet me faktin se FSHMT në UET është Fakulteti i ri dhe kërkon kohë për tu konsoliduar si emër në Shkencat Mjekësore Teknike, ndërkohë që disa Institucione të tjera funksionojnë prej disa vitesh. Gjithashtu fusha e infermierisë ka kërkesë më të pakët për studime në Master i Shkencave, pasi niveli Bachelor është i mjaftueshëm për punësim brenda dhe jashtë vendit si trend i viteve të fundit. Studimet Master i Shkencave i përshtaten një kontigjenti infermierësh të cilët synojnë thëllim profesional dhe punësim në fushën akademike. UET planifikon që numri i studentëve të rritet në mënyrë të konsiderueshme në vitet e ardhshme akademike. Me anë të grupeve të këshillimit të karrierës në UET, si edhe shtrirjes së aktiviteteve të tyre në Institucionet shëndetësore në Tiranë dhe në qytetet e tjera u ofrohet informacioni i nevojshëm lidhur me kriteret e pranimit, regjistrimit dhe ndjekjes së programit në UET.
5. Vështirësi në diversifikimin e burimeve të financimit. Institucioni mbështetet kryesisht në tarifat e shkollimit të studentëve, dhe është vulnërabel ndaj trendit në ulje të numrit të studentëve, si për shkak të vendosjes së notës mesatare në ciklin e parë të studimeve, ashtu edhe për shkak të rritjes së kuotave të sektorit publik, apo synimit të studentëve për të vazhduar studimet jashtë vendit.

Lista e dokumenteve mbështetëse për procesin e akreditimit të programit të ciklit të dytë të studimit: Master i Shkencave në “Infermieri”

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti i UET
3. Plani Strategjik UET 2015-2020
 - 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020
 - 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025
 - 3.3 Plani Strategjik UET 2021
4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit
5. Rregullore e UET
 - 5.1 Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi lëshimin e formave te diplomave
 - 5.2 Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19
 - 5.3 Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021
6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit
7. Rregullore e programit të studimit MSH Infermieri
 - 7.1 Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve
 - 7.2 Formati i tezës së provim it përfundimtar
8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë
9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore
10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit
 - 10.1. Kalendarit akademik 2018-2019
 - 10.2. Kalendarit akademik 2019-2020
 - 10.3. Kalendarit akademik 2020-2021
11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore
 - 11.1. Shembull thirrje për staf akademik
12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit
 - 12.1. Bordi i Tregut të Punës & Network i bashkëpunëtorëve FSHMT
 - 12.2. Poster_Panairi i punës 2018 dhe 2019
 - 12.3. Realitetet e Reja të Post-Coved 19 në Tregun e Punës 2020
13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave
14. Kurrikula e programit MSH Infermieri
 - 14.1. Plani mësimor i programit
 - 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - MSH Infermieri
15. Modeli i diplomës (**Urdhëri i aprovimit – nuk ka, pritët akreditimi**); Modeli i Suplementit të Diplomës
16. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit
17. Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve
18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes
19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite
 - 19.1. Formati i Syllabusit Cikli i parë dhe dytë
20. CV e stafit akademik të programit të studimit
21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit) (**nuk ka**)
22. CV e stafit ndihmës akademik (**nuk ka**)
23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabela 6)

25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit (Aneks Tabela 4)
26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjës
27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin
 - 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve
 - 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik
28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin
29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve
30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC
 - 30.1. Plani veprimit KSBC
 - 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë
 - 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2020
 - 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC
 - 30.5. Metodologjia e punës së KSBC_Provimet
 - 30.6. Format_Raporti për provimet
 - 30.7. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset
 - 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu
 - 30.9. Fisha e projektit Enchase
 - 30.10. Fisha e projektit QAinAL
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane (**nuk kanë dalë ende aktet nga MASR**)
32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale(Aneks Tabela 5)
 - 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale
 - 32.2 B-I-4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga Studenti)
33. Të dhëna për trajnimet profesionale
34. Marreveshje Bashkëpunimi UET
 - 34.1 Memorandum bashkëpunimi_UET-Poliklinika Gjermane
 - 34.2 Memorandum bashkëpunimi_UET-Salus
 - 34.3 Marreveshje Bashkëpunimi UET_QSUT
 - 34.4 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe QKU
 - 34.5 Memorandum Bashkëpunimi_UET-Gjermani
 - 34.6 Kontrate Qiraje_UET-Spitali Amerikan
 - 34.7 Memorandum bashkëpunimi_UET-Spitali i Traumes
35. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve
36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit
37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve
38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënies dhe aftësisë profesionale
39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës
40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët
 - 40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve
41. G-I-12-1 Formular i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik
42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit
43. Të dhëna mbi projektet, shkëmbimet, publikimet dhe veprimtaria kërkimore e stafit akademik

- 43.1 Mobility Agreement_IIA_UET-Cordoba
- 43.2 Të dhëna mbi aktivitetet FSHMT – Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
- 44. Format Dosje staf akademik (**administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE**):
 - 44.1 Format dosje staf akademik me kohë të plotë
 - 44.2 Format dosje staf akademik me kohë të pjesshme
- 45. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MSH “Infermieri”:
 - 45.a Lista e artikujve
 - 45.b Lista e teksteve
 - 45.1 Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës
 - 45.2 E-IV-2 Formular per pasurimin e fondit te librave ne biblioteke
 - 45.3 Shembull procedure_blerje literature
- 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS
 - 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS
 - 46.2 UET LMS Guide per pedagogun
 - 46.3 UET LMS Guide per studentet
 - 46.4 Video-trajtime mbi sistemin TEAMS/LMS
 - 46.5 Raport: ecuria e mësimit online
- 47. Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al; <http://uet.edu.al/new/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike>
- 48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online
- 49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1)
- 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)
- 51. Politika e marketingut të programit të studimit
- 52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (**Nuk ka – program i ri**)
- 53. Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”
 - 53.1 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar
 - 53.2 VKM Nr. 531, datë 11.06.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”
- 54. UMASR Nr. 665, datë 15.10.2018 “Për hapjen e programit MSH Infermieri, UET”
 - 54.1 VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 “Për hapjen e UET”
 - 54.2 UMASR Nr. 530, datë 04.09.2018 “Për hapjen e FSHMT në UET”
 - 54.3 VBA Nr. 12, datë 07.04.2017 “Për akreditimin institucional të UET”
 - 54.4 VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 “Për akreditimin e UET”
 - 54.5 Certifikatë Akreditimi UET
- 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)
 - 55.1. Kalendar i aktiviteve
- 56. A.II. Kodi i Etikës